

# PROGRAMI PËR MBËSHTETJE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

Bëjmë Qytete më të Mira  
Një dekadë së bashku



*Implementuar nga:*

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

*Financuar nga:*

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**





# PROGRAMI PËR MBËSHTETJE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

Bëjmë Qytete më të Mira  
Një dekadë së bashku

*Implementuar nga:*

**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

*Financuar nga:*

**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



**SWEDEN**

---

## MOHIM I PËRGJEGJËSISË

---

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti apo zone, apo të autoriteteve të tij, ose në lidhje me caktimin e kufijve të tij, ose në lidhje me sistemin e vet ekonomik ose shkallën e zhvillimit. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit për Vendbanimet Njerëzore të Kombeve të Bashkuara, të Kombeve të Bashkuara apo shteteve anëtare. Ekstrakte nga publikimi mund të ribotohen pa autorizim me kusht që të tregohet burimi.

Për UN-Habitat-in, të gjitha referencat për Kosovën janë bërë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999).

E drejta e autorit © United Nations Human Settlements Programme (UN-Habitat) 2014

Të gjitha të drejtat e rezervuara  
United Nations Human Settlements Programme (UN-Habitat)  
PO Box 30030, Nairobi 00100, Keni  
Tel: +254 20 7623120;  
Fax: +254 20 76234266/7 (Selia qendrore)  
infohabitat@unhabitat.org  
www.unhabitat.org

Kopertinat © UN-Habitat

---

## MIRËNJOHJE

---

Të gjithë fotografitë dhe ilustrimet e përdorura në këtë dokument i përshkruajnë aspektet e ndryshme të punës së UN-Habitatit në Kosovë. Të gjitha janë e drejtë e mbrojtur e autorit © UN-Habitat në Kosovë përveç nëse specifikohet ndryshe në tekst. Fotografitë dhe ilustrimet mund të riprodhohen me kusht që burimi të jetë i shtypur në fotografi apo ilustrim.

Të gjitha seksionet e këtij publikimi janë hulumtuar, përpiluar dhe shkruar nga Carol Howard, Konsulente për UN-Habitat-it në Kosovë. Intervistat gjithashtu janë zhvilluar nga Carol Howard. Mirënjohje dhe falenderime ekipit të MuSPP-it që ka dhënë udhëzime, ka bërë rishikime dhe ka kontribuar.

Falenderime dhe mirënjohje plotësuese i dedikohen partnerëve të ndryshëm MuSPP-it, zyrtarëve të qeverisë dhe stafit teknik në nivel qendror dhe lokal, përfaqësuesve të organizatave jo-qeveritare, universiteteve dhe shoqërisë civile, të cilët ofruan kohën e tyre dhe treguan storiet e tyre në mbështetje të zhvillimit të këtij publikimi:

Adnan Maloku, Afrim Demiri, Agim Radoniqi, Agron Kuqi, Amir Bushi, Arben Çitaku, Bedri Hoti, Besa Luzha, Besnik Osmani, Blerim Zulfaj, Dejan Jovanović, Djurdja Vulević, Durim Dernjani, Enver Tahiri, Esra Osi, Fakete Kuka, Ferdane Tofaj, Fisnik Minci, Gazmend Muhaxheri, Hiljmnijeta Apuk, Hysni Sylja, Ilir Gjinolli, Imer Suma, Isni Kilaj, Jeton Hoxha, Kadrije Myrtaj, Laura Ukimeri, Luan Nushi, Lum Kastrati, Miqail Vila, Mirjana Stanojević, Modest Gashi, Murat Kryeziu, Mustafë Zariqi, Nait Hasani, Nasrulla Krasniqi, Nataša Dimitrijević, Nexhmedin Qerkini, Nora Arapi, Qazime Vata, Qemajl Mustafa, Rufki Suma, Sali Shoshi, Saranda Krasniqi, Sazan Ibrahim, Shpejtim Mustafa, Suzana Goranci, Sylejman Dakaj, Valdete Morina, Veton Mujaj, dhe nxënësit e Shkollës së Mesme "Hamdi Berisha" në Malishevë dhe të Shkollës Filllore "Hamëz Thaqi" në Rahovec.

Ky publikim, si pjesë e Programit për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor Komunal, është i financuar nga Swedish Development Cooperation, të cilët jo domosdoshmërisht ndajnë pikëpamjet e shprehura në këtë dokument.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

---

<b>Prezantimi i MuSPP-it</b>	05
I - Konteksti	07
II - Kontributi unik i UN-Habitat-it për planifikimin hapësinor dhe planifikimin me pjesëmarrje në Kosovë	08
III - MuSPP-i, 'Krah për krah me Komunat'	27
Nga Planifikimi në Zbatim	36
IV - MuSPP-i mbështetë parnerët vendor	52
V - MuSPP-i – Këshilltar i besueshëm	60
VI - Aktivitetet e MuSPP-it për Arritje deri te Komuniteti	68
<b>Hapat e Ardhshëm</b>	72

## SHKURTESAT DHE AKRONIMET

<b>ABGj</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>AKK</b>	Asociacioni i Komunave të Kosovës
<b>CHwB</b>	Trashëgimia Kulturore pa Kufij
<b>DBH</b>	Dita Botërore e Habitat-it
<b>FES</b>	Friedrich Ebert Stiftung/ Fondacioni
<b>FUB</b>	Forumi Urban Botëror
<b>GIS</b>	Sistemi Informativ Gjeografik
<b>HZK</b>	Harta Zonale e Komunës
<b>IPH</b>	Instituti për Planifikim Hapësinor
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MM</b>	Memorandum Mirëkuptimi
<b>MTPT</b>	Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit
<b>MuSPP</b>	Programi për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor Komunal
<b>NALAS</b>	Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore
<b>OJQ</b>	Organizata joqeveritare
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>OZhM</b>	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
<b>PIK</b>	Projekt i Investimeve Kapitale
<b>PHZV</b>	Planet Hapësinore për Zona të Veçanta
<b>PRrU</b>	Plani Rregullues Urban
<b>PVPE</b>	Plani i Veprimit për Partneritet Europian
<b>PZSK</b>	Plani për Zbatimin e Standardeve në Kosovë
<b>PZhK</b>	Plani Zhvillimor Komunal
<b>PZhU</b>	Plani Zhvillimor Urban
<b>REC</b>	Qendra Rajonale e Mjedisit
<b>Sida</b>	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>SWOT</b>	Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet
<b>UN-Habitat</b>	Programi për Vendbanimet Njerëzore i Kombeve të Bashkuara
<b>USAID</b>	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
<b>VMRrK</b>	Vlerësimi dhe Menxhimi i Rrezikut të Katastrofave
<b>VSM</b>	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
<b>ZAMV</b>	Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut

# Prezantimi i MuSPP-it

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinorë Komunal (MuSPP-i) financohet nga Swedish Development Cooperation dhe zbatohet nga Programi për Vendbanimet Njerëzore i Kombeve të Bashkuara (UN-Habitat-i). Ekipi i MuSPP-it ka siguruar asistencë teknike për partnerët, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH-në) dhe komunat e Kosovës. Nga viti 2005 e deri më tani, MuSPP-i ka bërë një ndryshim të madh në Kosovë. Ai ka ofruar mundësi për njerëzit e rëndomtë, shërbyesit civil dhe zyrtarët e zgjedhur që të angazhohen në aktivitetet e planifikimit për të mirën e të gjithë njerëzve në komunitetet ku ata jetojnë apo veprojnë. Kjo broshurë ka për qëllim të ilustroj një përzgjedhje të gjerë të rezultateve dhe ndikimeve të MuSPP-it, në atë mënyrë që shpresohet se do të inspiroj të tjerët që të marrin pjesë në procesin e planifikimit të zhvillimit të komuniteteve të tyre.

Aktivitetet e MuSPP-it kanë hapur kanale të komunikimit ndërmjet Qeverisë, MMPH-së, ministrive të tjera përkatëse të linjës, Institutit për Planifikim Hapësinor, agjencive të tjera qendrore, si dhe stafit të komunave dhe qytetarëve të cilëve ju shërbejnë. Një nga planerët lokal theksoi se *“MuSPP-i i trajton të gjithë me respekt, pavarësisht pozitës së tyre, ne kemi fituar besimin dhe tani ndjehemi rehat të punojmë me cilëndo nga Ministrinë”*.

Fillimisht, UN-Habitati ka trajnuar zyrtarët e MMPH-së dhe Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH) i cili është themeluar me ndihmën e UN-Habitat-it. Ky trajnim i njoftoi ata me proceset e reja të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor, duke hapur kështu mundësitë për të zhvilluar karrierën e tyre. Po ashtu, trajnimi i stafit komunal nga MuSPP-i, ka rezultuar jo vetëm në prezantimin e planifikimit hapësinorë me pjesëmarrje në punën e tyre por edhe në aftësitë menaxhuese dhe të komunikimit që gjithashtu kanë ndryshuar praktikën e punës si në drejtoritë për urbanizëm ashtu edhe në drejtoritë e tjera komunale. Ndonjëherë, kjo ka ndryshuar formën e menaxhimit të tërë administratës komunale.

Ofrimi i trajnimeve në vend të punës nga MuSPP-i ka rezultuar me transferimin e njohurive të nevojshme praktike tek planerët komunal, të nevojshme për të udhëhequr procese të planifikimit hapësinor dhe për të hartuar plane hapësinore me kapacitete vetanake në komune. *Planerët tani mund të Planifikojnë!*

Palët e interesit duke përfshirë qytetarët e rëndomtë janë fuqizuar që të formësojnë komunitetet ku ata jetojnë, si dhe kanë përjetuar përfitimet e të punuarit së bashku për të mirën e përbashkët që mund të rezultojë në të mira të prekshme të cilat të gjithë mund t'i shfrytëzojnë. Nuk është e lehtë të pëfshihen njerëzit, sidomos gratë. Integrimi gjinorë është një prej vlerave thelbësore të MuSPP-it dhe ka shumë shembuj të mënyrave kreative të përfshirjes së femrave, duke filluar që nga gjetja e një mënyre për të

bindur një amvisë për të lënë familjën që të mund të largohet nga shtëpia për të përcjell një punëtor të vizionimit, e deri tek angazhimi i grave të të gjithë zyrtarëve komunal, duke iu kërkuar që të thërrasin mikeshat e tyre që të vijnë në një takim në lidhje me planifikimin e zhvillimit të komunitetit të tyre.

Prezantimi i mjeteve të vizionimit përmes punëtorive nga MuSPP-i sigurisht ka ndryshuar përgjithmonë mënyrën se si hartohen planet në komunat partnere të MuSPP-it. I gjithë koncepti i dërgimit të një grupi të njerëzve, nga të gjithë sektorët e shoqërisë, së bashku, në një vend larg shtëpive të tyre për disa ditë, në mënyrë që të fokusohen vetëm në hartimin e një plani zhvillimorë për komunitetin e tyre nuk është konsideruar më parë. Rezultatet kanë mahnitur edhe vet pjesëmarrësit, të cilët vështirë se besojnë se kanë arritur aq shumë në një periudhë aq të shkurtër kohore. Pasiqë janë hartuar projektet të cilat kanë lindur nga deklaratat e vizionimit në përfundim të punëtorisë së vizionimit, ato iu janë prezantuar pjesës tjetër të komunitetit. Palët e interesit nuk ishin vetëm të befashuar, por ata gjithashtu ndiejnë pronësinë mbi Planet Zhvillimore Komunale (PZHk-të) të cilat janë bërë nga vizionet e anëtarëve të rregullt të komunitetit të tyre.

Përfshirja e palëve të interesuara, përfshirë këtu edhe publikun, në procesin e planifikimit u bë më e lehtë dhe më e dukshme me vijimin e projekteve demonstruese në fazën e parë të programit, kur MuSPP-i prezantoi projektet e investimeve kapitale (PIK-ët). Këto projekte janë bashkë-financuar nga MuSPP-i dhe komunat partnere dhe paraqesin shembuj praktik të cilët rrjedhin nga planet zhvillimore dhe sjellin rezultate të dukshme për komunitetin. Vetë PIK-ët janë shumë të ndryshëm duke filluar nga vendosja e “pengesave në rrugë” përreth shkollës në mënyrë që fëmijët të jenë të sigurt, deri tek hapja e vendeve të bukura për publikun duke prezantuar shtigje të alpinizmit dhe objekteve për vizitorë.

MuSPP-i ka ofruar këshilla ligjore për MMPH-në dhe komisionin parlamentar në hartimin dhe rafinimin e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor. Prezantimi i Hartës Zonale të Komunës në ligjin e ri për planifikim hapësinorë nënkupton se komunat do të vazhdojnë të përballen me sfida të planifikimit. MuSPP-i tashmë ka ofruar trajnimin mbi përdorimin e GIS-it, i cili është një nga mjetet e domosdoshme për të bërë këto harta të reja.

Ndërtimi i kapaciteteve është ofruar në formë të trajnimeve, vizitave studimore, zhvillimit të politikave dhe ofrimit të udhëzimeve për MMPH-në, IPH-në, ministritë e linjës dhe komunat. Planifikimi i integruar në çështje të tjera ndër-sektoriale është realizuar përmes partneriteteve, pjesëmarrjes së përfaqësuesve në konferenca ndërkombëtare, forume botërore dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të tilla si “Tour de Culture” me Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) dhe organizimin e ngjarjeve në Ditën Botërore të Habitatit.

MuSPP-i ka zhvilluar udhëzime që do të shfrytëzohen në vitet në vijim. Të gjitha produktet e MuSPP-it janë duke u grumbulluar me qëllim të krijimit të një **Përmbledhje udhëzuesish praktik nga MuSPP-i: Udhërrëfyesi ynë drejt vetëqëndrueshmërisë**, që do të vazhdojë të jetë një burim i gatshëm për përdorim për institucionet qeveritare në nivel qendror dhe lokal, organizatat jo-qeveritare, universitetet, sektorin privat, shoqatat profesionale dhe shoqërinë civile.



# Konteksti

## PLANIFIKIMI NË KOSOVË ËSHTË NË TRANZICION

Edhe pse ka kaluar më shumë se një dekadë pas përfundimit të konfliktit në mes të vitit 1999, Kosova ende është në proces të tranzicionit.

Institucionet e Kosovës janë duke ndërmarrë hapa të qartë drejt demokracisë, ekonomisë së tregut dhe integritit evropian. Është e rëndësishme që këto hapa të dërgojnë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Zhvillimi urban kaotik, ndërtimi ilegal, vendbanimet joformale, ajri dhe lumenjtë e ndotur, deponitë ilegale, rritja e dyndjeve në trafik dhe sfidat e mobilitetit si dhe humbja substanciale e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, janë vetëm disa nga faktorët që paraqesin kërcënime për cilësinë e jetës.

Që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, UN-Habitat-i ka promovuar konceptin e planifikimit urban dhe hapësinor gjithëpërfshirës, strategjik dhe të orientuar në veprim. Adaptimi në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare ka kërkuar legjislacion, institucione, dhe praktika të reja të planifikimit. Legjislacioni i planifikimit hapësinor të Kosovës është zëvendësuar me një qasje gjithëpërfshirëse, moderne, dhe multidisciplinare të planifikimit.

MuSPP-i ka prezantuar procese të reja, ndërsa shoqëria civile dhe pushteti lokale gradualisht janë duke u bërë gjithnjë e më të vetëdijshme për nevojën dhe vlerën e shtuar të planifikimit dhe veprimit me pjesëmarrje. Hartimi i planeve hapësinore me kapacitete vetanake dhe përfshirja e të gjithë sektorëve të komunitetit janë themelore për qasjen e MuSPP-it. Kjo ka dërguar në nivele më të larta të angazhimit të njerëzve të zakonshëm dhe përfshirjen më direkte dhe transparente të palëve relevante të interesit në planifikimin e aktiviteteve të pushteteve të tyre lokale.

# Kontributi unik i UN-Habitat-it për planifikimin hapësinor dhe planifikimin me pjesëmarrje në Kosovë

UN-Habitat-i ka sjellë në Kosovë një qasje krejtësisht të re në procesin e qeverisjes demokratike në përputhje me parimet dhe metodologjinë kyçe në kuadër të disa fushave kyçe. Ato janë si më poshtë:

Parimet kyçe:

Qeverisja e mirë, gjithëpërfshirja, transparencja, llogaridhënia, barazia, dhe standardet ndërkombëtare

Metodologjia kyçe:

Ngritja e kapaciteteve, trajnimi në vend të punës, asistencë ligjore dhe teknike, zhvillimi dhe shfrytëzimi i mjeteve.

Fushat kyçe në Kosovë:

Menaxhimi komunal dhe territorial, efikasiteti i sektorit publik, integrimi i të gjitha komuniteteve, parandalimi dhe rregullimi i vendbanimeve joformale, promovimi i zhvillimit ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit

## Programi i mbështetjes së planifikimit hapësinor komunal (MuSPP)

Projekti **Programi i mbështetjes së planifikimit hapësinor komunal (MuSPP-i)** ka filluar në vitin 2005 dhe **është ndërtuar mbi përvojat e mëparshme të UN-Habitat-it në Kosovë**. MuSPP-i financohet nga Sida, Swedish International Development Cooperation. Aktiviteti kryesor i programit MuSPP-it është **fuqizimi i kapaciteteve të cilat duhet të çojnë drejtë vetë-qëndrueshmërisë përmes aplikimit të teknikave moderne të planifikimit hapësinor dhe planifikimit me pjesëmarrje**.

## Rreth Programit të mbështetjes së planifikimit hapësinor komunal 2005-2015

Qëllimi i përgjithshëm i programit është që **të kontribuojë në përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e kushteve jetësore të qytetarëve të komunave partnere të MuSPP-it përmes përforsimit të planifikimit zhvillimor komunal**.

Programi synon **ngritjen e kapaciteteve dhe strukturave institucionale për planifikim zhvillimor komunal dhe urban të përmirësuar dhe gjithëpërfshirës, i cili merr parasysh nevojat e burrave dhe grave dhe rezulton me plane strategjike të cilat i japin drejtim të arsyeshëm investimeve publike dhe private dhe zhvillimit të qëndrueshëm komunal dhe urban**.



## Qëllimet e MuSPP-it

MuSPP-i kishte tri faza, në të cilat objektivat dhe aktivitetet brenda secilës nga tri këto faza ndjekin një radhitje logjike, ku secila është ndërtuar mbi sukseset e fazës paraprake.

Në fazën e parë të MuSPP-it, prioritetet ishin si në vijim:

- Të ndihmojë komunat në hartimin e planeve komunale dhe urbane përmes këshillimit dhe udhëzimit në vend të punës në baza ditore, duke asistuar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Organizatat e Shoqërisë Civile për të mbështetur dhe për të marrur pjesë në mënyrë aktive në këtë proces.

### Aktivitetet e programit ishin të përqendruara në:

- Asistimin e komunave në hartimin e planeve zhvillimore komunale dhe urbane në mënyrë gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrje dhe të ndjeshme gjinore përmes ofrimit të asistencës dhe udhëzimeve në vend të punës për organet komunale të planifikimit, zyrtarë të qeverisë lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorit privat.
- Forcimin e dialogut mes nivelit komunal dhe qendror për çështjet që lidhen me politikat e nivelit lokal, çështjet legjislative dhe të planifikimit për të rritur harmonizimin në fushën e planifikimit hapësinor gjithëpërfshirës, strategjik dhe të orientuar në veprim.
- Ndëtimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit privat për pjesëmarrje aktive në ndërtimin e konsensusit mbi planifikimin zhvillimor hapësinor në nivel komunal dhe që të jenë një partner i informuar i qeverisjes lokale në procesin e planifikimit. Kjo është ndërmarr gjatë avokimit për nevojat e grupeve specifike shoqërore, si për grat dhe burrat ashtu edhe për djemtë dhe vajzat si pjesë e praktikave të qeverisjes së mirë.
- Mbështetjen e planifikimit të veprimit dhe asistimin në zhvillimin e pilot projekteve të veprimit të identifikuar përmes procesit të planifikimit.

Këto objektiva **janë përditësuar dhe përshtatur gjatë fazave të ardhshme të MuSPP-it** për të mbajtur hapin me ndryshimet në sistemin e Planifikimit Hapësinor të Kosovës gjatë 10 viteve të Programit.

Në fazën e dytë të MuSPP-it, aktivitetet në ngritjen e kapaciteteve të komunave vazhduan dhe u prezantuan Projektet e Investimeve Kapitale (PIK-ët).

Në fazën e tretë, MuSPP-i përsëri u fokusua në zhvillimin e qëndrueshëm të komunave partnere nëpërmjet ndërhyrjeve të planifikimit strategjik dhe gjithëpërfshirës me fokus të veçantë në mjedis, së bashku me përmirësimin e demokracisë lokale dhe përmirësimin e mjedisit fizik. MuSPP-i ofroi mbështetje për ngritjen e kapaciteteve në katër komunat e reja partnere të MuSPP-it.

Gjithashtu, ishte prioritare mbështetja e MMPH-së dhe IPH-së dhe organeve të tjera qendrore në zhvillimin e politikave dhe strategjive për Planifikimin Hapësinorë dhe Mjedisor në mënyrë që të sigurohet se ata janë të përgatitur të ofrojnë asistencë të vazhdueshme për komunat.

Komunat partnere të MuSPP-it janë si më poshtë:

- **Ferizaji**
- **Gjilani**
- **Gjakova**
- **Graçanica**
- **Hani i Elezit**
- **Juniku**
- **Malisheva**
- **Mamusha**
- **Mitrovica**
- **Parteshi**
- **Peja**
- **Prizreni**
- **Rahoveci**

## Çfarë ka arritur MuSPP-i deri më tani?

### NGA PLANIFIKIMI...

- **Planifikimi me pjesëmarrje** është prezantuar dhe zbatuar në 12 komuna në tërë territorin e Kosovës. **Të gjitha Komunat partnere kanë Planet Zhvillimore Komunale (PZHK-të).**
- Janë prezantuar **Vlerësimet Strategjike Mjedisore** për të mbështetur PZHK-të.
- Është realizuar trajnimi i gjerë **në vend të punës** për stafin e komunës, mbi përdorimin e të gjitha veglave të planifikimit hapësinor, **auditimit të zonës, vizionimit, përfshirja gjinore në planifikim, mekanizmat e konsultimit publik, proceset e tenderimit dhe menaxhimit të biznesit. Gjithashtu si pjesë e planifikimit hapësinor është përdorur edhe sistemi GIS.**
- Janë **fuqizuar kapacitetet komunale** sa i përket **dizajnimit të projektit, menaxhimit, realizimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të projektit**, si dhe në inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet drejtorive.
- Është kuptuar vlera e **trajnitimit në vend të punës**. Trajnimi i zgjeruar i bazuar në nivelin lokal është vlerësuar shumë dhe ka mundësuar **mësime dhe pronësi të konsiderueshme mbi planet hapësinore.**
- Natyra e detajuar e **asistencës së ofruar i është përshtatur nevojave dhe kapaciteteve ekzistuese të komunave në fjalë**. Komunat e reja të vogla kanë kapacitete të kufizuara sa i përket përvojës dhe stafit në dispozicion, mirëpo janë zhvilluar mënyra të ndryshme për të punuar në mënyrë më efektive me ta.
- Përdorimi i **vizionimit, trajnimeve, seminareve dhe vizitave studimore** ka qenë i rëndësishëm për komunikimin e njohurive dhe frymëzimin e stafin dhe anëtarëve të zgjedhur.
- **Shërbimet e vazhdueshme këshilluese** janë ofruar sipas kërkesës për MMPH-në, IPH-në dhe agjencitë e tjera qeveritare në shumë fusha, përfshirë këtu edhe mjedisin, vendbanimet jo-formale, zonat e veçanta të mbrojtura dhe VSM-në.

### ...DERI TEK ZBATIMI

Integrimi i **Projekteve të Investimeve Kapitale (PIK-ve)** ka qenë pjesë shumë efektive e punës. Kjo ka pasur disa përfitime të rëndësishme:

- **Janë ofruar shembuj të shkallës së vogël, të dukshëm dhe të kuptueshëm të asaj se çka do të thotë planifikimi me pjesëmarrje** dhe arsyet se pse këto mund të përbëjnë një strategji efektive.
- **Mjedisi dhe cilësia e jetës** në vendbanime është përmirësuar.
- Lidershipi, stafi dhe organizatat partnere, **përfshirë shoqërinë civile lokale janë motivuar.**
- **Ndërtimi i pronësisë:** Projektet janë diskutuar në kuvendet komunale dhe janë zotuar burimet komunale në përputhje me rrethanat dhe kjo ka siguruar një pronësi më të fuqishme. **Është siguruar lidhja** në mes të **investimeve prioritare dhe buxheteve komunale.**

### DERI TEK QËNDRUESHMËRIA E MuSPP-it ...

- **Janë publikuar dokumente dhe udhëzime relevante mbi atë se si të planifikojmë duke qenë të vetëdijshëm për çështjet gjinore si dhe për çështjet e rinisë, të moshuarve dhe minoriteteve të tjera**, që mundëson një integrim më të gjerë të grupeve të cënueshme.
- Mbështetja iu është dhënë **institucioneve qendrore ndërsa ata i kanë mbështetur qeveritë lokale.**
- Është prodhuar një **Përmbledhje gjithëpërfshirëse udhëzuesish praktik nga MuSPP-i**, e cila mund të përdoret në mënyrë të vazhdueshme nga ministritë, komunat dhe palët e interesit.

*“UN-Habitat-i ka një marrëdhënie të gjatë me këtë Ministri. Ekipi i MuSPP-së na ka mundur që ti qasemi dhe tejkalojmë sfidat me të cilat ne përballemi në prezantimin e planifikimit me pjesëmarrje si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal dhe na kanë ndihmuar praktikisht në zbatimin e ligjeve. Gjithashtu, UN-Habitat-i ka vendosur marrëdhënie të mira në mes të Ministrisë dhe komunave. Anëtarët e stafit të Ministrisë dhe Institutit për Planifikim Hapësinor kanë mësuar nga përvoja njësoj sikurse planerët në komuna. Është shumë më mirë që planerët komunal t'i bëjnë planet e tyre me kapacitete vetanake në komunë, dhe MuSPP-i ju ka dhënë kapacitetet për ti bërë ato plane”, Arben Çitaku, Sekretari i Përgjithshëm, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.*



## Qasja gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrje dhe barazia gjinore, e MuSPP-it

Qasja gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje si dhe barazia gjinore janë integruar dhe zbatuar në praktikë në të gjitha proceset e planifikimit të mbështetura nga MuSPP-i.

Parimet tona kyçe janë si në vijim:


- **Të gjithë anëtarët e komunitetit mund të marrin pjesë** në procesin e bërjes së një plani hapësinor për zonën e tyre.
- Opinionet dhe idetë e të gjithë sektorëve të komunitetit duhet të **shqyrtohen dhe pasqyrohen, deri në shkallën e mundshme**, në planin lokal hapësinor.
- Integrimi i **perspektivës gjinore në të gjitha aktivitetet** e të bërit të një plani hapësinor duhet t'iu kontribuojë grave nga komuniteti që janë të përfshira dhe të sigurohet që kontributi i tyre vlerësohet.
- **Përfshirja proaktive e personave me aftësi të kufizuara** në procesin e planifikimit duhet të siguroj qasje më të mirë për ta në të gjitha planet hapësinore lokale.
- **Kushdo nga komuniteti**, pavarësisht se a përfaqëson një biznes apo një OJQ, apo është amvisë apo studentë, **janë të mirëpritur që të marrin pjesë** në procesin e bërjes së planit hapësinor të zonës së tyre, në mënyrë që **komuniteti lokal të marrë pronësinë dhe përgjegjësinë për planin** duke besuar se kështu ka më shumë gjasa që të vazhdojnë mbështetjen e planit gjatë dhe pas zbatimit të tij.



Tryeza e rrumbullakët me gra në lidhje me PZHK-në



## PALËT E INTERESIT NË PLANIFIKIMIN HAPËSINORË



## Ngritja e kapaciteteve themelore, menaxhimi dhe komunikimi nga MuSPP-i



*‘MuSPP ka sjellë një gamë të gjerë të ekspertëve dhe ekspertizës në komuna, ndërsa MAPL-ja ka punuar së bashku me komunat në prezantimin e praktikave të reja të planifikimit dhe hartimin e ligjeve të reja. Rrjetëzimi është shumë i rëndësishëm, prandaj për stafin tonë, MuSPP-i ka lehtësuar rrjetëzimin me dhe të mësuarit nga përvojat e të tjerëve, gjë të cilën ata e zbatojnë në punën e tyre të përditshme’.* Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

- Koncepti se të gjitha nivelet e qeverisjes duhet të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë në planifikimin hapësinorë komunal si dhe **niveli qendror dhe lokal duhet të punojnë së bashku**.
- Praktikave të zyrëtarëve të MuSPP-it të **cilët punojnë me orar të plotë nëpër komuna**, së bashku me stafin e tyre planifikues, në të gjitha proceset e planifikimit hapësinorë. Trajnimi në vend të punës ishte një koncept i ri dhe në interes të stafit komunal të cilët tani kanë kapacitetet **që vet të menaxhojnë procesin e planifikimit në komunë**. Ky është **një ndryshim i praktikës**, pasi që hartimi i PZHK-ve shpesh kontrakttohej me kompanitë private dhe më pas i prezantohej komunitetit, në atë mënyrë që vetëm se përmbushte kërkesat ligjore.
- Prezantimi jo vetëm i **praktikave të mira të planifikimit** por edhe i **aftësive themelore të menaxhimit dhe komunikimit** nga ana e zyrëtarëve të MuSPP-it ka ndihmuar stafin komunal të menaxhojë gjithë punën e tyre në mënyrë më efektive.

- MuSPP-i në vend që të organizojë financimin për Projektet e Investimeve Kapitale në nivel qendror, **ajo ka vënë burimet në dispozicion të komunave**. Kjo ka ndihmuar në **ngritjen e kapaciteteve të tyre**, për shkak se ata vetë, së bashku me ndihmën e zyrtarëve rezidentë të MuSPP-it, **është dashur të menaxhojnë secilin aspekt të procedurës së tenderimit**.
- Zyrtarët e MuSPP-it kanë ndihmuar komunat dhe kontraktuesit në zbatimin e projekteve të investimeve, duke i treguar **kontraktuesve teknikat e përmirësuar**, të cilat jo vetëm që do të siguronin një **projekt të investimit kapital me cilësi të lartë** në komunën përkatëse por gjithashtu i jepnin kontraktuesve kapacitetin për të prodhuar produkte të cilësisë së lartë edhe në të ardhmen.

## Teknikat themelore të planifikimit hapësinorë të prezantuara nga MuSPP-i

### PROFILIZIMI KOMUNAL

Ky është një hulumtim mbi situatën aktuale në fushën e cila do të mbulohet përmes një plani.

Kjo përfshinë:

- **Sondazhet** e banorëve dhe bizneseve në atë zonë në mënyrë që të identifikohen nevojat e tyre, të merren idetë e tyre se si ata do të dëshironin që të përmirësohej rrethina e tyre
- **Vizitat në terren** për identifikimin e çështjeve brenda zonës së planit
- **Mbledhja dhe analizimi i të gjitha të dhënave statistikore** që i takojnë asaj zone, siç janë të dhënat sociale, mjedisore, shëndetësore dhe të dhënat nga regjistrimi.

### VIZIONIMI

Vizionimi është thjeshtë një proces përmes të cilit komuniteti parashikon të ardhmen që e dëshiron dhe planifikon se si të arrij atë. Ai bashkon njerëzit për të zhvilluar një imazh të përbashkët të asaj se çfarë ata duan që komuniteti i tyre të bëhet. Vizioni është imazhi i përgjithshëm i asaj që komuniteti dëshiron të jetë dhe atë se si dëshiron që të duket në të ardhmen. Deklarata e vizionit është shprehje formale e atij vizioni, ndërsa dizajni i vizionit është shprehje vizuale e atij vizioni.

Vizioni i komunitetit është pikënisja kyçe në Planifikimin Strategjik Hapësinor. Nga ana tjetër, kjo është pjesë e kornizës më të gjerë të planifikimit të qëndrueshëm zhvillimor, e nevojshme për të kanalizuar zhvillimin e qëndrueshëm hapësinor dhe urban për tërë shoqërinë.

Shtytësit kryesorë **të ndryshimit nga "mos-pjesëmarrja" drejt "partneritetit" dhe "fuqisë qytetare" nuk janë planerët por shoqëria civile, së bashku me një pjesë të klasës politike, qëllimi i të cilës është që të fuqizojë njerëzit dhe të krijojë një "kulturë të pjesëmarrjes".**

Thelbi i procesit të vizionimit është ofrimi i kushteve për rrjetëzim dhe krijim të mundësive që grupe të ndryshme të njerëzve të bashkohen dhe të ndërveprojnë.

### Kush duhet të përfshihet?





## Punëtoritë e vizionimit nga MuSPP-i

- Vizionimi është zhvilluar si hapë fillestar i procesit të planifikimit me pjesëmarrje. Shpesh, sfida fillestare ishte që të bindet menaxhmenti dhe stafi komunal se **punëtorja e vizionimit është e domosdoshme** në mënyrë që t'i mundësojë komunës të arrij një **vizion të përbashkët për PZHK-në e tyre, e cila do të plotësonte nevojat e qytetarëve dhe do të tentonte të përmirësoj mjedisin e tyre.**
- Më pas të punoj me komunën për të gjetur **rreth 35 dhe 40 palë të interesit nga të gjithë sektorët e shoqërisë, biznesit, shoqërisë civile, OJQ-ve, grave, studentëve, gazetarëve, të papunëve, mësimdhënësve dhe profesorëve.** Ky grup i njerëzve duhej të përgatiteshin që të qëndrojnë për 4 net dhe 5 ditë larg shtëpisë, për të analizuar gjendjen aktuale në qytetin e tyre dhe të përpilojnë një vizion për zhvillimin e tij gjatë njëzet viteve të ardhshme. Më pas, ata duhej ta paraqesin në hartë dhe ta prezantojnë atë. Ky ishte një zotim veçanërisht i vështirë për gratë me familje.

Punëtoritë e vizionimit nga MuSPP-i



- Disa komuna kanë kontraktuar hartimin e PZHK-së. Në këtë rast, **kompania** në fjalë është **ftuar në punëtori.**
- Vizionimi është përdorur për **PZHK-të, Planet Zhvillimore Urbane (PZHU-të), dhe Planet Rregulluese Urbane (PRrU-të) siç ishte rasti në Pejë,** me çrast u krijuan vizione për Planet më të vogla Rregulluese Urbane në kuadër të Planit Zhvillimor Urban.
- **Prioritetet e identifikuar në vizionet e tyre u bënë bazë për planet** që do të prodhoheshin dhe shpesh disa nga këto priorite u shndërruan në Projekte të Investimeve Kapitale
- Të gjithë pjesëmarrësit **punuan me shumë zell së bashku** për të arritur qëllimet e tyre. Kryetarët e komunave ishin ftuar gjatë prezantimeve, në mënyrë që ata mund të shohin **se sa shumë mund të arrihet dhe se si mund të përfitoj komuna e tyre gjithashtu.**
- **Friedrich-Ebert-Stiftung (FES-i)** ka bashkëpunuar me MuSPP-in gjatë punëtorive të vizionimit nëpërmjet financimit dhe ekspertizës.



## Vizionimi për Mitrovicën

Me rastin e pjesëmarrjes në punëtorin e parë të vizionimit, të organizuar nga MuSP-i në vitin 2007, qytetarë e Mitrovicës kanë shënuar një moment të rëndësishëm sa i përket zhvillimit të Planifikimit Hapësinor në Kosovë. Jo vetëm që ishte punëtorja e parë e mbajtur ndonjëherë në Kosovë në të cilën merrnin pjesë qytetarët në përcaktimin e të ardhmes për zonat në të cilat jetonin për më tepër kjo punëtori u përcjell nga përfaqësuesit e Mitrovicës veriore dhe asaj jugore. Të dyja palët kanë punuar së bashku në krijimin e një deklarate të vizionit për zhvillimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për tërë Mitrovicën.

Kriza ekonomike dhe cilësia e ulët e jetës nga e cila po vuanin njerëzit si në pjesën veriore të qytetit ashtu edhe në atë jugore ishte pikënisje për një këmbim të mendimeve dhe dialog në mes të dy komuniteteve. Duke shprehur shqetësimet dhe preferencat e tyre, njerëzit nga të dy pjesët e qytetit identifikuan çështjet e përbashkëta dhe punuan së bashku në zgjidhjet nga të cilat mund të përfitojnë të gjithë.

Punëtorja arriti të angazhojë dhe fuqizojë shoqërinë civile dhe organizatat mediale në Mitrovicë të jugut dhe veriut, si dhe të forcojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe planerëve profesional të Mitrovicës veriut dhe jugut.

Punëtorja e vizionimit për Mitrovicën



## Qytetarët e Parteshit hartojnë vizionin për komunën e tyre të re

Parteshi është një komunë e sapo krijuar në vitin 2010, me një popullsi prej 5000 banorëve, ku shumica e tyre jetojnë në zona rurale dhe janë të punësuar në ferma. Punëtorja e Vizionimit për Komunën e Parteshit është mbajtur me qëllim të inicimit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Kjo u dëshmuar të jetë një përvojë krejtësisht e re për palët e interesit. Punëtorja e vizionimit u organizua bashkërisht nga MuSPP-i, Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB-ja), Friedrich Ebert Stiftung (FES-i), me mbështetjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH-së).

Grupi i pjesëmarrësve në punëtori nga Komuna e Parteshit përbëhej nga: zyrtarë komunal, shoqëria civile, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe qytetarëve në përgjithësi.



Pjesëmarrësit u ndanë në 4 grupe punuese, dhe ata punuan në aspekte të ndryshme të komunës së tyre, dhe rezultati përfundimtar ishte deklarata e përbashkët e vizionit dhe dy moto. Deklarata e vizionit është si vijon: *"Komunë e re me traditë të pasur kulturore, vetëdije ekologjike, me bujqësi të transformuar dhe infrastrukturë që ka aspirata për zhvillim të qëndrueshëm"*. Rezultatet e punës intensive në punëtorinë 4-ditore u përdorën si bazë për udhëheqjen e procesit të hartimit të PZHK-së dhe u prezantua tek një audiencë më e gjerë në komunë.

Gjithashtu morën pjesë kryetari i komunës së Malishevës, një tjetër komunë partnere e MuSPP-it. **Kryetari i komunës Malishevës u impresionua aq shumë sa që vendosi që vet komuna të hartonte PZHK-në me kapacitete vetanake dhe ndihmën e MuSPP-it në komunë.**

## Vizionimi për PZHK-në e Ferizajt

Afrim Demiri, gazetar në gazetën 'Koha Ditore' ishte ftuar në punëtorinë e vizionimit për PZHK-në e Ferizajt. *"Ishte një përvojë e mirë",* tha ai. *"Gjithashtu morën pjesë shumë palë të interesuara nga qeverisja lokale dhe shoqëria civile. Janë ndërtuar ura që lidhin qytetarët si pjesë e procesit të planifikimit. Mënyrën se si ata ju qasën aktiviteteve planifikuese na kanë entuziazmuar. Një nga rezultatet e punëtorisë së vizionimit ishte një konkurs ndërkombëtar për dizajnimin e planit të mobilitetit.*

*Qasja e MuSPP-it për planifikim me pjesëmarrje ka bërë përmirësim në mënyrë indirekte në qeverisjen lokale. MuSPP duhet të vazhdoj me kontributet e tyre ndërvepruese, posaçërisht në këtë kohë kur do të prezantohen hartat zonale".*



## Barazia gjinore



Punëtori trajnuese mbi çështjet gjinore

Barazia është një e drejtë themelore e shoqërisë dhe ngërthen të gjitha aspektet e jetës: kulturën, qytetarinë, sportin, etj. Megjithatë, pjesëmarrja e gruas në shumë fusha përfshirë planifikimin hapësinor është e ulët në Kosovë.

MuSPP-i i ka dhënë përparësi përfshirjes dhe pjesëmarrjes së gruas, përgjatë gjithë ndihmesës së ofruar ndaj komunave me qëllim që të krijoj dhe realizoj planet hapësinore në nivel lokal. Gjithashtu është theksuar që barazia gjinore nuk ka të bëjë vetëm me çështjet e grave, por me çështje të rëndësishme për çdonjërin.

MuSPP-i në çdo mundësi të ofruar **ka inkurajuar hapa pro-aktiv për përfshirjen e grave dhe burrave. Gratë dhe burrat kanë nevojë të ndryshme prandaj sjellin pikëpamje të ndryshme në procesin e planifikimit.** Shumë komuna janë ballafaquar me vështirësi që t'i bindin qytetarët të marrin pjesë nëpunëtori të vizionimit, tryeza të rrumbullakëta dhe konsultimeve në procesin planifikimit, por duke punuar me komuna, MuSPP-i ka dëshmuar se 'kur ka vullnet, ka rrugëdalje'. Në disa raste angazhimi i një gruaje ka hapur derën e përfshirjes së më shumë grave. Për shembull udhëheqja dhe entuziazmi i një gruaje në Junik, ka çuar në formimin e OJQ-së së Grave anëtarët e së cilës jo vetëm që marrin pjesë në planifikimin hapësinor, por edhe në aktivitete tjera të komunitetit. Kultura dhe tradita në disa zona e ka bërë më të vështirë përfshirjen e gruas. Komuna e Mamushës, një vendbanim me popullatë turke, ka fituar mbështetjen e liderëve fetarë. Zakonisht gratë nuk merrnin pjesë në takime publike, por kur u zbulua se po flitej për një projekt për përmirësimin e oborrit të shkollës që ishte në dobi të fëmijëve të tyre, disa gra u përfshinë në këtë projekt.



## Përparimi i grave në Ferizaj

Përfshirja e grave në procesin e planifikimit hapësinor po ecën mirë në Ferizaj.

Qazime Vata aktualisht këshilltare komunale në Kuvendin e Komunës në Ferizaj, më parë Drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm për gjashtë vite, njëkohësisht gruaja e parë që udhëhoqi këtë drejtori. Në këtë cilësi, ajo filloi të punojë me MuSPP-in, me ç'rast të gjitha proceset e planifikimit përfshinin edhe gratë. Fillimisht qasja e sjellë nga MuSPP-i ishte të kontaktoj nënat, veçanërisht në fshatra. Një mësimdhënëse organizoi një mbrëmje të prindërve në një fshat ku u shtruan çështjet e planifikimit dhe OJQ-ja e grave ndihmoi në pjesëmarrjen e grave në punëtorinë e vizionimit dhe barazisë gjinore. Shumica e ideve nga gratë pjesëmarrëse në punëtorinë e vizionimit, janë përfshirë në PZHK dhe fjalët e tyre të sakta janë përfshirë në Deklaratën e Vizionit.

Siç mund të shihet edhe nga foto, pjesëmarrja e grave gjatë konsultimeve për Korridorin e Gjelbër ishte e kënaqshme.



Punëtoritë e PIK-ve në Ferizaj.



Znj. Vata beson se është bërë përparim i madh gjatë nëntë viteve të fundit në përfshirjen dhe pjesëmarrjen e grave, ku tani janë dy drejtoresha në komunën e Ferizajt, ekziston një grup i fuqishëm i grave në Kuvendin Komunal, madje Kosova ka edhe kryetaren e parë të zgjedhur ndonjëherë në ndonjë komunë. Ka ende shumë për të bërë, por përpjekjet e MuSPP-it për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e grave në aktivitetet e komunitetit kanë qenë të mëdha.

MuSPP-i ka organizuar shumë punëtori mbi Pjesëmarrjen Gjinore, me qëllim ngritjes së njohurive të pjesëmarrësve sa i përket barazisë gjinore dhe procesit të planifikimit. Disa nga çështjet e trajtuara ishin:

- Futja e aspekteve gjinore në proceset e planifikimit hapësinor dhe urban, konceptet dhe aplikimi i tyre;
- Theksimi i rëndësisë së integritimit gjinor dhe përfshirja e tij në politikat e planifikimit dhe menaxhimit;
- Sigurimi i pjesëmarrësve me kornizën konceptuale mbi perspektivën gjinore dhe marrëdhëniet e saj me procesin e planifikimit hapësinor;
- Përcaktimi i veprimeve dhe metodologjive të nevojshme për zbatim;
- Gjenerimi/identifikimi i veprimeve të ndjeshme gjinore të nevojshme gjatë procesit të PZHK-së.



Fakete Kuka dhe Kadrije Myrtaj nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) kanë bashkëpunuar, që nga viti 2004, me UN-Habitat-in dhe MMPH-në lidhur me çështjet e perspektivës gjinore. Ato përqendrohen në prezantimin e grave që nga fillimi i procesit të planifikimit, nëpërmjet vizionimit dhe zhvillimit të planit, deri te monitorimi i projektit prej fillimit deri në përfundim. Në vitin 2003 ka filluar emërimi i Zyrtarëve Gjinor në të gjitha dikasteret qeveritare, megjithatë, ishte MuSPP-i ai që i inkudroj ata në mënyrë aktive në veprime lidhur me çështjet gjinore.




MuSPP-i ka hartuar **Udhëzues mbi Integrimin Gjinor në Planifikimin Hapësinor**, që është mirëpritur veçanërisht në komuna, me ndihmën e një grupi punues të përbërë nga MMPH-ja, Agjencia për Barazi Gjinore, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Universiteti i Prishtinës si dhe përfaqësuesit e MAPL-së.

## Qasja e MuSPP-it në planifikim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë

Qasja e MuSPP-it në planifikim të zhvillimit të qëndrueshëm mbi parimet në vijim:

- Kuptimin e përfitimeve të bashkëpunimit dhe marrëveshjen rreth parimeve me shoqërinë civile si dhe me autoritetet lokale dhe qendrore;
- Planifikimin me pjesëmarrje që nga fillimi i procesit;
- Inputet e vazhdueshme dhe të qëndrueshme në kuadër të autoriteteve përkatëse të planifikimit janë të domosdoshme;
- Qasja me pjesëmarrje në Projektet e Investimeve Kapitale si dhe planifikimi për zona të veçanta, si dhe për procese tjera të ngjashme është thelbësore;
- Planifikimin me pjesëmarrje është një domosdoshmëri për të kuptuar qytetin dhe nevojat e qytetarëve;
- Partneriteti duhet të ndërtohet në vazhdimësi ndërmjet autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile;
- Pjesëmarrja e komunitetit/publikut duhet të përfshihet më shumë në legjislacion dhe në praktikë.

### VAZHDIMËSIA E PJESËMARRJES - LLOJET E PJESËMARRJES



## PLANET HAPËSINORE

### Korniza ligjore


Ligji i parë i Kosovës për Planifikimin Hapësinor është miratuar në vitin 2003.

### Elementet e Ligjit për Planifikim Hapësinor të vitit 2003


Instrumentet e planifikimit të kërkuara nga ky ligj në **nivel kombëtar** janë **Plani Hapësinor i Kosovës (PHK-ja)** dhe **Planet Hapësinore për Zonat e Veçanta (PHZV-të)**.

#### Ndërsa në nivel komunal:


- **Plani Zhvillimor Komunal (PZHK),**
- **Plani Zhvillimor Urban (PZHU), dhe**
- **Planet Rregullative Urbane (PRrU).**



Plani Zhvillimor Komunal është një plan afatgjatë për tërë komunën. Plani Zhvillimor Urban është një plan për një zonë urbane, pra është një nën-kategori e Planit Zhvillimor Komunal; dhe Plani Rregullues Urban është për një zonë specifike në kuadër të Planit Zhvillimor Urban siç tregohet edhe në diagramin e mëposhtëm. Planet e nivelit lokal duhet të jenë në harmoni me ato të nivelit qendror.



Planet Zhvillimore Komunale janë **Plane të Integruara** të cilat marrin parasysh nevojat e gjithë komunitetit, si: sociale, ekonomike dhe mjedisore. Shtyllat kyçe të Planifikimit Komunal janë ilustruar më poshtë:



## Implikimet e ligjit të ri mbi Planifikimin Hapësinor

Sipas Ligjit të ri mbi Planifikimin Hapësinor, të vitit 2013, PZHK-ja bëhet dokumenti strategjik që përfshin proceset e njëjta si më parë siç janë: grumbullimi i të dhënave, përcaktimi i profilit, objektivave dhe vizionimit për të përcaktuar prioritetet strategjike. PZHU-të dhe PRrU-të nuk janë më të nevojshme. Në vend të këtyre, janë futur Harta Zonale e Komunës (HZK-ja), të cilat janë një transformim i prioritetëve strategjike të PZHK-së në terma të shfrytëzimit të tokës, që përfshin hartat me planet e veprimit përmes një sistemi të zonimit. Nëse konsiderohet e domosdoshme, në kuadër të HZK-së mund të detajohen Planet Rregulluese të Hollësishme për Zonat e Veçanta.





MuSPP-i së bashku me palët tjera mbështetëse është ende duke punuar me MMPH-në për të hartuar Udhëzimet Administrative të cili mundësojnë zbatimin e këtij ligji të ri.

## Komuna e Malishevës dhe MuSPP-i testojnë implikimet e Ligjit të Planifikimit Hapësinor të vitit 2013

PZHK-ja e Malishevës është plani i pari që do të hartohet në kuadër të ndryshimeve që janë bërë në ligjin e ri mbi Planifikimin Hapësinor të vitit 2013.

Ish-Kryetari i Komunës së Malishevës shpjegoi se, "PZHK-ja e Malishevës fillimisht i është kontraktuar me një kompanie italiane. Pas një viti, komuna nuk ishte e kënaqur as me standardin e punës e as me koston. Pas një takimi me MuSPP-in si dhe duke parë mënyrën e funksionimit të programit, komuna vendosi të anulojë kontratën dhe të hartoj PZHK-në me kapacitete vetanake në komunë, me ndihmën e MuSPP-it. Në këtë mënyrë, planerët do të zhvillojnë kapacitetet e tyre duke i bërë vet ato plane, por njëkohësisht do të ulëshin edhe shpenzimet."



PZHK-ja e Malishevës është një pilot projekt që është duke u zhvilluar paralelisht me hartimin e Udhëzimit Administrativ për PZHK-në (që rrjedhë nga Ligji i ri për Planifikimin Hapësinor). Kjo mund të bëhet PZHK-ja e parë e Kosovës, që është në përputhje me legjislacionin e ri.

## MIRATIMI I PLANEVE


Para miratimit të PZHK-së nga ana e Kuvendit Komunal, ajo duhet t'i dërgohet MMPH-së në mënyrë që të sigurohet harmonizimi me Planin Hapësinor të Kosovës si dhe me Planet e Veçanta për Zonat e Mbrojtura (nëse është relevante për territorin e komunës në fjalë).

MuSPP-i ka asistuar komunat në marrjen e miratimit të PZHK-ve duke siguruar kontrollin e cilësisë së planeve para se ato të dorëzohen tek autoriteti përkatës dhe ka siguruar nderlidhje ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale të planifikimit.

## VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR (VSM-ja)

VSM-ja është një proces i projektuar për të siguruar që efektet e rëndësishme mjedisore që rrjedhin nga planet dhe programet e propozuara të identifikohen, vlerësohen, zvogëlohen, t'i nënshtrohen pjesëmarrjes së publikut, të merren në konsideratë nga vendimmarrësit dhe të monitorohen. VSM-ja është bërë një instrument i rëndësishëm për të ndihmuar arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në planifikim dhe hartim të politikave. Si e tillë, VSM-ja është një proces i dobishëm për të ndihmuar vendimmarrjen gjatë hartimit të planeve në Kosovë.

Direktiva Evropiane për VSM-në (2001/42/EC) është adoptuar në legjislacionin e Kosovës përmes Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, në vitin 2010. Sipas atij ligji, “qëllimi i VSM-së është të sigurojë që pasojat mjedisore janë identifikuar dhe vlerësuar gjatë përgatitjes si dhe para miratimit të planeve dhe programeve të caktuara”. Planet Zhvillimore Komunale janë ndër dokumentet të për të cilat kryerja e VSM-së është kërkesë ligjore.



VSM-ja si pjesë e procesit të planifikimit strategjik © UNEP (2014) Integrimi i shërbimeve të ekosistemit në Vlerësimin Strategjik Mjedisor: Udhëzues për praktikues

Legjislacioni i Kosovës mbi VSM-në ndjek **parimin e përgjithshëm** se procesi i VSM-së duhet të kryhet **paralelisht** me procesin përgatitor të vlerësimit të planit dhe kjo duhet të finalizohet para miratimit të planit në mënyrë që të përfshij ndryshimet apo korrigjimet e nevojshme në plan.


MuSPP-i kishte organizuar një **pilot projekt** me qëllim të prezantimit të VSM-së në PZHK-në e **Junikut** paralelisht me prezantimin e rregullores së VSM-së dhe kjo ka mundësuar krijimin e proceseve. VSM-ja ishte një procedurë e re për MMPH-në dhe pilot projekti ishte shumë i vlefshëm për Ministrinë dhe tregoi se si mund të prezantohet një VSM.

VSM-ja e dytë që MuSPP-i kishte ndihmuar ishte ajo e komunës së Hanit të Elezit me ç'rast kjo ishte VSM-ja e parë që ishte hartuar pasi që rregullorja u shndërrua në ligj. Pastaj për hartimin e VSM-ve të PZHK-ve pasuese të hartuara me kapacitete vetanake nga komunat e Graçanicës, Parteshit, Mamushës dhe Malishevës, ekspertët e MuSPP-it kanë ndihmuar komunat për t'i hartuar VSM-të paralelisht me PZHK-të e tyre, dhe me këtë rast MuSPP-i ka vazhduar të inkurajojë komunat që të bëjnë këtë, përmes prezantimit të Udhëzuesit për hartimin e VSM-së.

Në secilën punëtori, gjatë periudhës së hartimit dhe konsultimit të PZHK-së, **një grup punonte veçanërisht në VSM-në.** Edhe pse në disa raste u desh kohë për stafin komunal që të shohin vlerën e VSM-së pasi që çështjet mjedisore ishin pjesë integrale e PZHK-së, por me zhvillimin e VSM-ve ishte kuptuar edhe vlera e tyre.

*Për shembull në Junik, kur ishte planifikuar të bëhet pastrimi i hapësirës në të cilën do të zhvillohej Parku Moronica, komuna kishte planifikuar t'i largojnë të gjitha drunjt përveç një lloji. VSM-ja kishte theksuar se kjo do të dëmtonte të gjithë florën dhe faunën si dhe do të çrregullonte bilancin mjedisor, prandaj asnjë lloj i drunjve në park nuk ishte prekur. Gjithashtu VSM-ja tregoi se puna për rregullimin e shtratit të lumit Erenik do të zvogëlonte nivelin e ujit, prandaj kjo do të shkaktonte ngordhje të peshqve, me ç'rast ishte ndryshuar thellësia e ujit dhe ishte ndërtuar një pellg për peshqit.*

Në Prizren, PZHK-ja ishte kontraktuar, ndërsa MuSPP-i ndihmoi komunën të bëjë një VSM në mënyrë retrospektive ashtu siç është bërë edhe në Rahovec, prandaj çështjet mjedisore të ngritura në VSM duhej të prezentoheshin në PZHK. VSM-të janë studime të rëndësishme që do të ndihmojnë procesin e vendimmarrjes së komunës në të ardhmen të cilat janë të dedikuara për përmirësimin e performancës socio-ekonomike dhe mjedisore të PZHK-së.



Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Mamushën

Fotografi © Plani Zhvillimor Komunal 2014 - 2023

## Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM-ja) i Rahovecit

Një ekspert i MuSPP-it ka trajnuar stafin e komunës mbi hartimin e VSM-së, me ç'rast janë ngritur edhe kapacitetet e tyre për këtë çështje.

Arkitekti i komunës, Z. Shpejtim Mustafa theksoi se *'VSM-ja ishte një risi për ne, dhe MuSPP-i na mësoi përvojat më të mira dhe pastaj ofroi asistencë për të bërë vlerësimin. VSM-ja kishte rritur në mase të madhe ndërgjegjësimin mjedisor.'*



## Përfitimi i më të mirës nga GIS-i

GIS-i (Sistemi Informativ Gjeografik) është një mjet thelbësor i planifikimit që mund të përdoret nga komuna për të krijuar të dhëna hartografike nga secili sektor. Ky është një mjet për krijimin e hartave që mundëson gjeo-lokalizimin, referencimin dhe analizimin e të dhënave. Kjo mund të ndihmojë në njohjen e territorit, çështjeve brenda territorit, identifikimit të boshllëqeve dhe kësaj mënyre të **ndihmimit vendimmarrës gjatë hartimit të politikave.**

Kur të dhënat, siç janë ato nga regjistrimi i popullsisë apo nga studimet e kryera për profilizimin komunal apo nga studimet tjera komunale apo hulumtime të mbledhura nga një zonë e caktuar, futen në sistem, dhe ky sistem do të ndaj informatat sipas temës dhe krijoj harta për ato tema. Ndonjëherë ka pak të dhëna në dispozicion. Në Mamushë, për shembull, e cila është një komunë e re, nuk kishte të dhëna në dispozicion dhe për këtë arsye **MuSPP-i ka ndihmuar komunën në kryerjen e një studimi të detajuar socio-ekonomik, derë më derë, për të gjeneruar të dhëna që do të futeshin në sistemin GIS për të krijuar një varg të hartave dhe propozim hartave.**



Sesioni i trajnimit mbi GIS-in



**Roli i MuSPP-it ishte kyç në ofrimin e trajnimeve themelore dhe të avancuara mbi përdorimin e sistemit GIS në të gjitha 12 komunat e tyre partnere, si dhe Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut (ZAMV).**

**Agim Radoniqi, Zëvendës Drejtor i Departamentit të Planifikimit Hapësinor,** Ndërtimit dhe Banim, theksoi se *'Është e rëndësishme që ne të mbajmë në nivel të duhur kapacitetet e Planerëve Komunal. MuSPP-i ka trajnuar shumë planerë në përdorimin e sistemit GIS-it, i domosdoshëm për Hartat e reja Zonale të Komunave, por shërbimet e GIS-it ndoshta do të ofrohen në nivel rajonal, pasi që jo të gjitha komunat mund të përballojnë koston e softuerit dhe licencës së GIS-it. Është shumë e rëndësishme që të kemi një standard të lartë të planerëve që mund të hartojnë plane me pjesëmarrje. Ne kemi nevojë për plane të mira dhe praktike për të tërhequr investitorët në Kosovë.'*



# MuSPP-i, 'Krah për krah me komunat'

## Qasja e MuSPP-it gjatë punës me komuna

MuSPP-i është fokusuar në përgatitjen e planeve zhvillimore, me fokus të veçantë në cilësinë e mjedisit dhe ka lëvizur gjërat para përmes:

- Zhvillimit të kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e planit;
- Ushtrimit të qasjeve transparente dhe me pjesëmarrje;
- Prezantimit të qasjes së të mësuarit-duke-praktikuar ku është ofruar një mbështetje e mentorimit gjatë "bërjes me kapacitete vetanake në komunë" që zakonisht zgjat disa vite për të promovuar pronësinë lokale;
- Shfrytëzimit të programeve të investimeve modeste për të stimuluar mbështetjen dhe për të ofruar përfitime të dukshme;
- Dokumentimit dhe përhapjes së përvojave kyçe;
- Ushtrimit të qasjes së balancuar gjinore;
- Mbështetjes paralele për institucionet qendrore të cilat në kthim duhet të mbështesin autoritetet lokale.

## MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT PËR PRONËSI OPTIMALE KOMUNALE

MuSPP-i ka lidhur një Memorandum të Mirëkuptimit (marrëveshje reciproke dypalëshe), me secilën prej komunave të saj partnere, i cili përcakton përgjegjësitë e të dyja palëve brenda fushëveprimit të MuSPP-it. Kjo mbulon rezultatet që të dyja palët janë zotuar që të arrijnë, konfirmon aranzhimet institucionale dhe kësaj është një bazë e marrëveshjes ndërmjet MuSPP-it dhe secilës komunë.

## TRAJNIM NË VEND TË PUNËS PËR PLANERËT KOMUNAL

MuSPP-i fillimisht kishte ofruar trajnim në vend të punës në fazën e tij të parë duke siguruar një ekspert ndërkombëtar dhe dy ekspert lokal në gjashtë qytete të Kosovës: Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Prizren dhe Gjakovë. Në MuSPP2, ekspertët e specializuar për çështje si mobiliteti, kontrolli i zhvillimit dhe vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë (VMRrF) kanë mbështetur komunat e një zone. Gjatë fazës së dytë dhe të tretë të MuSPP-it janë përfshirë edhe shtatë komuna tjera siç janë: Juniku, Malisheva, Graçanica, Hani i Elezit, Parteshi, Mamusha dhe Rahoveci. Gjatë fazës së tretë, në secilën prej dymbëdhjetë komunave partnere ishte i angazhuar vetëm nga një zyrtar tereni rezident i MuSPP-it. Ky kombinim i këshilltarëve ndërkombëtarë dhe vendore të planifikimit për të mbështetur ekipet planifikuese komunale në punën e tyre të përditshme ka mundësuar një mjedis interesant të punës ku janë shkëmbyer përvojat dhe janë ngritur kapacitetet e ekipeve planifikuese komunale.

## MuSPP KA PREZANTUAR DHE FUNKSIONALIZUAR QASJEN "E PLANIFIKIMIT ME KAPACITETE VETANAKE NE KOMUNE"

MuSPP-i ka punuar me planerët komunalë dhe me zyrtarët tjerë komunal dhe ka forcuar kapacitetet e tyre për hartimin e PZHK-ve, PZHU-ve dhe PRRU-ve me kapacitete vetanake në komunë me qëllim të mos kontraktimit të tyre. Nëse për shkaqe të mungesës së kapaciteteve komuna duhej të kontraktonte hartimin e planeve me ndonjë kompani, atëherë MuSPP-i ishte siguruar që planerët komunalë të punojnë ngushtë me kontraktuesin, duke monitoruar çdo hap të zhvillimit të planit dhe siguruar se janë shfrytëzuar mjetet e kërkuara për planifikim hapësinor me pjesëmarrje. Kjo qasje ka pasur një ndikim të madh në ngritjen e kapaciteteve për palët e përfshira, duke rritur pronësinë mbi dokumentin dhe më pas perspektivat e zbatimit të tij. Aplikimi i një procesi me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse gjatë hartimit të dokumenteve planifikuese komunale kishte rezultuar në më shumë ndërveprimeve ndërmjet qeverive të nivelit lokal dhe qendror, të shoqërisë civile, të rinisë, grave dhe komunitetit të biznesit. Një tipar interesant i kësaj qasjeje ishte përsëritje e saj në komuna tjera të cilat dëshironin gjithashtu të shfrytëzonin Metodologjinë e MuSPP-it.

**MuSPP-i ka ndihmuar komunat që të bëjnë PZHK-të duke përdorur qasjen e Vizionimit që MuSPP-i kishte përgatitur dhe e cila është ilustruar më poshtë:**



Së pari, duhet të identifikohen nevojat dhe idetë e qytetarëve, pastaj ato duhet të analizohen dhe më pas të përcaktohen çështjet kyçe për zonën, me qëllim të hartimit të vizionit për komunën. Më pas, vizioni duhet të hartohet, komentet të kërkohen dhe diskutohen me ata që kanë kontribuar. Ky proces duhet të vazhdojë deri sa të arrihet marrëveshja dhe më pastaj mund të prezantohet në publik për komente të më tutjeshme. **Roli i Planerëve Komunal** në këtë fazë ka të bëjë me lehtësimin e proceseve të planifikimit me pjesëmarrje dhe në aranzhimin e ideve të palëve të interesit në plane hapësinore.

## Planet e komunave që janë ndihmuar nga MuSPP-i janë:

**PZHK-të** në të gjitha dymbëdhjetë komunat

**VSM-të** e për të vlerësuar ndikimin mjedisor të tetë PZHK-ve

**Vlerësimi i zbatimit të PZHK-ve** në Pejë, Junik dhe Ferizaj, kjo ka ndodhur shumë kohë pas hartimit të PZHK-ve përkatëse, me qëllim të vlerësimit se çka është bërë dhe çka jo

**'Gjenerata e re' e PZHK-ve**, duke filluar me pilot projektin në Malishevë

**PZHU-të dhe PRRU-të** brenda PZHK-ve, në rastin e Hanit të Elezit dhe Pejës

**Studimi për Menaxhimin e Ujërave**, në Han të Elezit

**Planet për menaxhimin e mbeturinave të ngurta**, në Han të Elezit dhe Junik

## Plani Zhvillimor Komunal (PZHK-ja) i Rahovecit

Zyrtarët e MuSPP-it kanë punuar me planerët në Rahovec që nga fillimi i hartimit të PZHK-së së tyre. PZHK-ja ishte kontraktuar por MuSPP-i ka ndihmuar komunën që të mbikëqyrë punën e kompanisë dhe të siguroj një kontroll të mirë të cilësisë në çdo fazë të procesit.

Sylejman Dakaj nga Drejtoria e Urbanizmit deklaroi se: *"Puna me MuSPP-in ishte një përvojë e shkëlqyer, kemi mësuar shumë. Zyrtarët e MuSPP-it na kanë udhëzuar gjatë tërë projektit. Kjo ishte një përvojë krejtësisht e re. Ne për herë të parë përcaktuam së bashku nevojat e komunitetit. Komuna do të vazhdojë me këtë qasje me pjesëmarrje në projektet tjera komunale në të ardhmen, pasi që MuSPP-i ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve tona për ta bërë një gjë të tillë."*



## Mamusha përdor teknologjinë e sistemit GIS në hartimin e PZHK-së dhe VSM-së


Përveç asistencës me trajnime në vendin e punës për planerët e Mamushës nga ana e MuSPP-it, edhe kursi i trajnimit në sistemet e GIS-it organizuar poashtu nga ana e MuSPP-it, i kanë mundësuar komunës që të hartoj Planin Zhvillimor Komunal dhe të kryej Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) përkatës duke përdorur teknologjinë e sistemit GIS.

Një bazë e të dhënave mbi informacione sektorale, për shembull, për mjedis, banim, infrastrukturë, mbeturina dhe ujë, është përpiluar dhe është futur në sistemin GIS. Shumica e drejtorive në kuadër të komunës kanë kontribuar në mbledhjen e të dhënave. Duke përdorur GIS-in, këto të dhëna sektorale janë transformuar në shtresa për të formuar një hartë. Prioritetet strategjike të PZHK-së kishin për qëllim ofrimin e hapësirave të gjelbra të hapura publike dhe zgjerimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e bujqësisë.

Znj. Esra Osi, një nga planerët komunale në Mamushë e cila ka punuar me ekipin e MuSPP-it, sqaroi se *'Mamusha është një komunë e re, e themeluar zyrtarisht në vitin 2008, pas një periudhe të pilotimit. Planerët lokal kërkuan mbështetjen e xhamisë që nga fillimi i përpjekjeve të tyre për të përfshirë qytetarët në planifikim hapësinor. Pas punëtorisë së vizionimit për Mamushën, filloi mbledhja e të dhënave për PZHK-në. VSM-ja është hartuar paralelisht me PZHK-në siç është rekomanduar nga MuSPP-i, në mënyrë që plani i vlerësuar të mund të përfundojë para se të bëhet miratimi, në mënyrë që të bëhet përfshirja e ndryshimeve apo të kryhen korrigjimet e nevojshme në plan për ta bërë atë të favorshëm ndaj mjedisit.'*



PZHK-ja për periudhën 2014 deri më 2023 propozon ndarjen e burimeve tokësore në zona bujqësore, natyrore dhe vendbanime. Korniza hapësinore e planit ka për qëllim ruajtjen e tokave me cilësi të lartë për bujqësi. Në të njëjtën kohë, ajo mundohet të përmbushë kërkesat e popullsisë në rritje përmes dendësisë dhe zgjerimit të matur. Në kushte të përgjithshme VSM-ja e finalizuar ka arritur në përfundim se plani zhvillimor synon përmirësimin e gjendjes aktuale ekonomike dhe mjedisore. Aktivitetet dhe komponentët e planit nuk përfshijnë ndonjë ndikim të madh negativ mjedisor. Përkundrazi, është analizuar se në qoftë se plani i tanishëm nuk do të zbatohet ka gjasa që gjendja e mjedisit të vazhdojë të përkeqësohet.



Skenario i preferuar- PZHK-ja e Komunës së Mamushës

Fotografi © Plani Zhvillimor Komunal 2014 -2023

## Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë (VMRrF)

Praktikat kanë treguar se në vendet në tranzicion, si dhe në Kosovë menaxhimit të fatkeqësive i kushtohet rëndësi vetëm pasi ato të ndodhin. MuSPP-i ka mbështetur komunën e Ferizajt dhe Gjilanit në integrimin e VMRrF-së në zhvillimin e politikave të tyre dhe në planifikim.



MuSPP-i po ashtu ka ndihmuar komunat në hartimin e **Strategjisë së Vlerësimit dhe Menaxhimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë**. Për të plotësuar strategjinë, është ofruar trajnim dhe është kryer një sondazh si pjesë e procesit të planifikimit.



Gjatë kryerjes së studimit për VMRrF

Në vitin 2010, MuSPP-i ka organizuar trajnime për ngritjen e vetëdijesimit mbi zbutjen e masave që ndikojnë tek përmbytjet përmes një projekti të investimeve kapitale (PIK) për reduktimin e përmbytjeve, i cili ishte realizuar nga MuSPP-i në komunën e **Ferizajt**.

### Zona me Rrezik nga Përmbytjet dhe Plani i Evakuimit nga studimi mbi VMRrF-së për komunën e Ferizajt



Studimi i bërë në zonën urbane të Gjilanit synonte identifikimin e rreziqeve, cenushmërinë e zonave dhe zonat e prirura për fatkeqësi, me qëllim të themelimit të orientimeve për zhvillim dhe menaxhimit të zhvillimit në të ardhmën.

Punëtori mbi Trajnimet Simuluese të Tërmetit si dhe në zhvillimin e masave zbutëse nga ndikimi i terrmeteve, janë organizuar në **Gjilan** si pjesë e këtij studimi.



## Gjithëpërfshirja në Projektet e Investimeve Kapitale (PIK-ët)

Planifikimi urban mund të jetë një aktivitet mjaft abstrakt pasi që fillimisht asgjë nuk mund të shihet përveçse një raport mjaft të dendur. Ndërsa lidhja e këij raporti me projekte të dukshme dhe të prekshme që vetvetiu demonstrojnë parimet e pjesëmarrjes, bashkëfinancimit, projektimit dhe përfitimit publik ofron një seri të përfitimeve të vlefshme potenciale, prandaj është shumë e rëndësishme. Disa nga komunat fillimisht e kishin të vështirë që të inkuadrojnë anëtarët e sektorëve të ndryshëm të shoqërisë në procesin e planifikimit. Projektet e Investimeve Kapitale kanë ofruar një qëllim real që banoret e komunës të mund ta synojnë, çka edhe ishte një nxitje e fortë për të ndihmuar përfshirjen e njerëzve.

Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës theksoi se *“Mënyra jonë e të menduarit ka ndryshuar, e tërë Administrata mendon ndryshe, pjesëmarrja e qytetarëve në planifikim ka pasur ndikim”*.



### Hani i Elezit, ‘Komunikimi për të përfshirë’!

Një nga aspektet më të rëndësishme të qasjes së MuSPP-it ndaj planifikimit hapësinor është **gjithëpërfshirja**.

Kjo sigurisht që është përqaftuar nga stafi i komunës së Hanit të Elezit.

**Stacion televiziv lokal** është burimi më i rëndësishëm i informacionit për komunitetin, prandaj komuna e shfrytëzoi më së miri këtë përparësi. Ky stacioni televiziv u shfrytëzua në mase të madhe për publikimin e vazhdueshëm të njoftimeve për **komunitetin lokal për kontributin e tyre** në planet e ardhshme hapësinore për Hanin e Elezit dhe për t’i ftuar ata të marrin pjesë në hartimin e tyre. Për këtë qëllim gjithashtu janë përdorur gazetatat lokale dhe kombëtare siç janë Koha Ditore dhe Zëri, ndërsa Facebook është përdorur për të ftuar të rinjtë, së pari për punëtorë dhe pastaj për konsultime rreth planeve të propozuara. Njoftimi fillestar u pasua nga ftesat dere me derë. Fletushka janë shpërndarë jo vetëm për të ftuar njerëzit në takime por edhe për të informuar ata mbi rezultatet e takimeve. Ishte bërë një përpjekje e vërtetë nga planerët komunalë të cilët ishin përkrahur nga MuSPP-i për përfshirjen e të gjitha palëve lokale të interesit, zyrtarëve komunal, shkollave, komunitetit shëndetësor dhe të biznesit, punonjësve të fabrikave, shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara, pronarëve të dyqaneve dhe restoranteve dhe publikut në përgjithësi. Kjo përfshirje ishte bërë përmes punëtorëve të projektimit ku pjesëmarrësit mundeshin të shprehnin idetë e tyre për qendrën e qytetit përmes diskutimeve dhe takimeve publike, kështu që përzgjedhja dhe zhvillimi i projektit kaloi nëpër një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje. Gjithsej 270 njerëz morën pjesë në takimin më të madh publik.



*Imer Suma nga OJQ Handikos ishte një nga ata që ishin të përfshirë në këtë proces. Ai shpjegoi se “MuSPP-i ishte programi i vetëm që me të vërtetë kishte përfshirë nevojat e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. Asnjëherë nuk jemi anashkaluar. Të tjerët na kanë ftuar vetëm për formalitet por MuSPP-i ka bashkëpunuar me kolegët e tyre në komunë dhe kanë siguruar 80 deri 90% qasje për personat me aftësi të kufizuara në projektet e tyre të investimeve kapitale. Ekipi kuptoi se njerëzit e vetëm që mund të testonin nëse objektet ishin funksionale për personat me aftësi të kufizuara, ishin vet personat me aftësi të kufizuara, pasi që ata në fakt mund të vërejnë nëse qasja është efektive, dhe të tjerët nuk mundën ta bëjnë atë. Mua më është kërkuar të testoj objektet në qendrën e qytetit, si dhe projektet e shkollës, dhe tani komuna e di se nëse unë kam testuar objektin dhe kam deklaruar atë objekt të kënaqshëm, atëherë ata janë bindur se produkti i ofruar është cilësor”*.



Gjithashtu në konsultimeve publike të Planit Rregullativ Urban për qendrën e qytetit, ishin të pranishëm një numër i vogël grash dhe kështu ishte organizuar një konsultim publik i veçant për gratë, pikëpamjet e të cilave dhanë një kontribut të çmuar drejt produktit final.

## Komuna e Rahovecit përfshinë të Gjitha Shkollat në një Konkurs për të Identifikuar Projektin më të Mirë për një PIK të MuSPP-it

Përmirësimi i objekteve arsimore dhe hapësirave publike ishte prioritet strategjik i PZHK-së së Rahovecit. Komuna kishte organizuar një konkurs për të **gjitha shkollat** për të identifikuar projektin më meritues për investime nëpërmjet PIK-ut të MuSPP-it. Konkursi kishte për qëllim zgjerimin e angazhimit publik dhe ngritjen e vetëdijes qytetare, nga ana e nxënësve dhe mësimeve. Përveç krijimit të një oborri të qëndrueshëm, projekti synonte të angazhojë komunitetin e shkollës në punë ekipore dhe të rris imagjinatën e nxënësve mbi çështjet urbane si dhe të përmirësoj ndërgjegjësimin mjedisor. Janë dorëzuar shtatëmbëdhjetë projekt-propozime nga 26 shkolla të komunës.

Konkursi kishte një konkurrencë të fortë dhe projekti për dy shkolla, për një shkollë fillore dhe për një shkollë të mesme ishin përzgjedhur fitues, 'Oborri i qëndrueshëm shkollor në shkollat Xhelal Hajda - Toni dhe Hamëz Thaqi'.



## Përfshirja e komunitetit në Planifikimin dhe Projektimin e PIK-ut në Mamushë

Znj. Esra Osi, planere komunale në Mamushë shpjegoi se "Nuk ishte e lehtë të përfshiheshin njerëzit, veçanërisht gratë që zakonisht nuk ishin të përfshira në konsultime publike. Edhe në mbledhjet e prindërve në shkolla, zakonisht është babai ai i cili shkon për të takuar mësimeve të fëmijës së tyre, dhe jo nëna. Ftesat për takime publike ishin shpallur në xhami dhe 500 ftesa ishin dorëzuar derë më derë. Nuk ka asnjë radiostacion lokal në Mamushë, vetëm stacioni televiziv i Prizrenit, kështu që është përdorur uebfaqja e komunitetit turk. Kur është bërë prezantimi i PIK-ut, është ofruar një objektivi i prekshëm dhe deri në 40 persona erdhën në takime publike, dhe shumë nxënës nga shkolla morën pjesë në fund të procesit. Në punëtorinë e parë ishte shpërndarë një pyetësor, ku pjesëmarrësit, mësimeve, drejtorët e shkollave, drejtori i arsimit dhe stafi i drejtorisë së arsimit nga komuna u pyetën se çfarë ata donin të shihnin, se cila ishte ëndrra e tyre për oborrin e shkollës? Bazuar në analizën e pyetësorit, ishte bërë një projekt me tri fusha të veprimtarisë, socializim, sport dhe rekreacion si dhe arsim. Dizajni iu është shpërndarë pjesëmarrësve për komentim. dhe pas përfshirjes së komenteve është kërkuar miratimi nga komuna dhe MuSPP-i."

## Natyrë e PIK-ve

Natyrë tematike e PIK-ve është në përputhje me prioritetet strategjike të PZHK-së. Projektet ishin bashkë-financuar në përpjesë 50/50 nga MuSPP-i dhe komuna, prandaj theksi ishte vënë në projekte modeste që me të vërtetë do të bënin ndryshime brenda komunitetit. MMPH-ja gjithashtu kontribuoi në disa nga projektet më të mëdha. Ndjenja e pronësisë dhe qasja me pjesëmarrje e MuSPP-it kishte inkurajuar komunat partnere të MuSPP-it bashkë-financojnë 17 PIK-a, përfshirë 7 projekte demonstruese.

Në disa raste objektivi i përzgjedhur ishte zhvillimi i mjedisit rreth shkollave; oborret shkollore në komunat e Junikut, Rahovecit, Hanit të Elezit, Mamushës dhe Graçanicës, janë transformuar në zona të cilat mund të shfrytëzohen si nga vet shkolla ashtu edhe nga komuniteti. Në Pejë është transformuar vendbanimi joformal Zatra. Në Prizren, është rigjeneruar dhe revitalizuar një rrugë e vjetër historike dhe sheshi kryesor, duke inkurajuar banorët që të restaurojnë fasadat e vjetra dhe të fillojnë biznese të reja. Në Ferizaj, një korridor i gjelbër ka bërë lidhjen e hapësirave të gjelbra si dhe është rregulluar një shtrat i lumit për të parandaluar përmbytjet. Parku i Moronicës, në Komunën e Junikut, është bërë me shtigje dhe hapësira për vizitorë. Janë vendosur pengesat në rrugë rreth një shkollë në Mitrovicë dhe janë gjelbëruar disa zona tjera të qytetit. Në Han të Elezit, zona qendrore përballë ndërtesës së komunës së qytetit është rinovuar, ndërsa në Malishevë është ndërtuar një urë e re më e gjerë ashtu që njerëzit të mund të kalojnë në mënyrë të sigurtë nga njëra anë në anën tjetër të qytetit.

## Oborri i shkollës në Rahovec

Murat Kryeziu Drejtor i Shkollës Hamëz Thaqi dhe dy nxënësit e tij, Nertila Krasniqi dhe Denis Kryeziu, shpejgojnë se si ka evoluar PIK-u.

Drejtori Kryeziu theksoi se *“Ne ndërmorëm një qasje shumë serioze me nxënësit duke shpjeguar se ky ishte një projekt shumë-disiplinor, i cili do të ndikojë jo vetëm në shkollë dhe tek nxënësit, por edhe në komunitetin, duke përfshirë edhe shumë bujq që mund t’i vendosnin produktet e tyre nga ferma në një hapësirë të re. Projekti shtoi forma të reja dhe cilësore të të mësuarit në shkollë. Shkolla tani ka një imazh më të mirë dhe fëmijët janë duke punuar më shumë. Gjashtëdhjetë përqind e propozimeve të paraqitura nga fëmijët ishin zbatuar, kështu që vizioni i tyre kishte dhënë fryte, për cka ata janë të lumtur ndërsa çështjet disiplinore janë përmirësuar”.*



Ekipi i shkollës Hamëz Thaqi

## Përmbledhja e procesit të PIK-ut

- Projektet e mundshme për investime kapitale janë përzgjedhur nga prioritetet strategjike të PZHK-së dhe janë vlerësuar sipas kriterëve për zbatimin e projektit të MuSPP-it;
- Vizioni dhe konsultimet me palët e interesit ndihmojnë identifikimin e PIK-ve të ardhshëm;
- Pasiqë PIK është përzgjedhur dhe projektuar, është bërë nënshkrimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim ndërmjet MuSPP-it dhe komunës përkatëse;
- Procesi i tenderimit për kryerjen e punëve dhe realizimin e projektit është iniciuar.

### Ndërtimi dhe monitorimi i PIK-ut “Oborret e Shkollave” në Rahovec

MuSPP-i vazhdimisht monitoron kompanitë fituese gjatë procesit të realizimit të punëve për të siguruar kualitetin e punës. Është shpallur një tender publik për kompaninë e cila do të realizonte projektin, dhe me këtë rast fitues ishte shpallur një kompani nga Malisheva.



Lum Kastrati, Arkitekt i Kompanisë

Z. Zulfaj tha: *“MuSPP-i ka këshilluar dhe monitoruar punën tonë. Ata ishin shumë të rreptë, ne duhej t'i përmbaheshim projektit. Më e mira ishte se projekti ishte shumë më lehtë për t'u realizuar sepse kishim udhëzime të sakta gjatë realizimit. Gjithashtu ishte një ndjenjë e mirë të punohej në këtë projekt për shkollat dhe komunitetin lokal, i cili përfshinte masa për të përmirësuar gjelbërimin në atë mjedis. Bashkëpunimi ndërmjet nesh, komunës dhe MuSPP-it ishte shumë i mirë gjatë gjithë periudhës së realizimit të projektit”.*



Blerim Zulfaj, Kontraktues

### Cilësia ishte gjëja më e rëndësishme në Hanin e Elezit

Nasrulla Krasniqi, përfaqësues i kompanisë fituese të tenderit për PIK për Qendrën e Qytetit të Komunës së Hanit të Elezit tha se: *“Ky është projekti i parë që kam bërë me komunën dhe MuSPP-in, dhe kjo ishte hera e parë që unë kam pasur një klient që monitoron cilësinë e punës së kompanisë sime. Monitoruesit nga komuna dhe MuSPP-i më dhëne këshilla dhe më ndihmuan në përmirësimin e standardeve tona të punës. Planet ishin hartuar me pjesëmarrje të njerëzve dhe ishin shumë të sakta dhe gjithçka duhej vetëm të ndërtohej si duhet. Ky projekt është shumë i dukshëm duke qenë se është në qendër të qytetit dhe puna cilësore që kemi bërë aty, ka sjell më shumë mundësi të biznesit.”*



## Ndikimi i PIK-ve

Kudo që janë realizuar PIK-ët, ato kanë ka ndikuar në sektorë të shumtë të komuniteteve. Është zakonisht natyra e projektit ajo që përcakton ndikimin më tepër se madhësia e tij.

Mobiliteti, siguria, integrimi urban, qasja në të gjitha shërbimet dhe vendet, furnizimi me ujë, mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, dhe rigjenerimi i qendrës së qytetit, janë disa nga çështjet kyçe në të cilat PIK-ët kanë kontribuar. Të gjitha këto Projekte të Investimeve Kapitale kanë përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve.

### Modifikimet e rrugëve

Renovimi i urës në Malishevë ishte një projekt që ka pasur efekt mbi të gjithë komunitetin, pasi që është ura e vetme mbi lumin që e ndan qytetin në gjysmë, prandaj të gjithë e shfrytëzojnë atë. Tani ura është më e gjerë, me trotuare për këmbësorë dhe me më pak ngecje në trafik për makina. Ndërsa pengesat në rrugë rreth shkollës në Mitrovicë ndikon vetëm tek ata shoferë që përdorin këtë rrugë.

## Oborret e Shkollave , Fushat Sportive dhe Takimet e komunitetit

Projektet të cilat përfshinin zhvillimin e oborreve të shkollave dhe fushave sportive jo vetëm që kanë pasur ndikim të madh në stafin, nxënësit dhe prindërit e tyre, por edhe në shkollat e tjera të cilat e shfrytëzojnë atë për lojëra apo për aktivitete të tjera kulturore ndër-shkollore. Projektet për oborre të shkollave dhe fusha sportive, zakonisht kanë pëfshirë zona të parqeve publike, të cilët kanë mundësi t'i shfrytëzojnë ato pas mësimit dhe gjatë fundjavës, kështu që projekti ka një ndikim të madh edhe në komunitetin lokal. Renovimi i shkollës dhe oborrit të saj në Radevë ka pas një ndikim të madh për nxënësit, pasi që bashkon komunitetet etnike që jetojnë aty.

## Trotuaret, Urat dhe Lumenjtë në Qytete

Këto kanë ndikimin më të madh në komunitetet lokale pasi që ata i shfrytëzojnë ato më së shumti, por në disa raste si në Pejë, rruga është pjesë e një projekti më të madh që përshkon qytetin dhe vazhdon deri në male.

## Shtigjet dhe objektet e vizitorëve në parqet rurale/kombëtare

Parku Moronica në Junik ka një urë të re hyrëse, një amfiteatër të hapur, vende për kampim dhe shtigje rreth parkut dhe tërheq jo vetëm komunitetin lokal, por gjithashtu edhe ata nga qytetet fqinje që vijnë për shëtitje nëpër këto shtigje, kryesisht gjatë fundjavës.

## Trashëgimia Kulturore

Në Prizren, dy projekte të bashkë-financuara nga MuSPP-i dhe komuna, janë në qendër historike të qytetit. Projekti Rruga e Farkëtarëve e ka shndërruar këtë rrugë vetëm për këmbësor dhe ka përmirësuar hapësirën publike, e cila ka pasur një ndikim të substancial. Bizneset janë duke funksionuar mjaft mirë dhe shumë banorë vendor dhe vizitorë kalojnë nëpër të çdo ditë. Pronarët e objekteve janë motivuar për rivendosjen e fasadave historike të ndërtesave. Ndërsa kafenetë dhe dyqanet përgjatë kësaj rruge janë jashtëzakonisht të popullarizuara gjatë Festivalit të Filmit Dokufest.

## Ndikimi i PIK-ut Oborret e Shkollave në Rahovec

Nxënësit thanë se tani është rritur ndërgjegjësimi mjedisor. Më parë ata kanë hedhur mbeturina në dysheme ose kudo, tani kanë shportat e mbeturinave që ata përdorin. Tani ata mendojnë për mirëmbajtjen e shkollës të tyre por edhe për mjedisin në përgjithësi. Gjithashtu i ka gëzuar fakti se kanë mundur të jenë pjesë e konkursit të projekt-propozimit por edhe e takimeve konsultative. Nxënësit gjithashtu janë angazhuar edhe në kërkime në internet me qëllim të gjetjes së shembujve më të mirë të oborreve të shkollave nga e gjithë bota, për t'u frymëzuar. Një nxënës bëri një video të shembujve më të mirë dhe ua tregoi atë fëmijëve tjerë.

Murat Kryeziu, Drejtor i shkollës Hamëz Thaqi shpjegoi: *“Ne tani kemi dy fusha sporti që të gjithë mund t'i përdorin, e para është një fushë solide basketbolli, hendbolli dhe volejboli dhe një fushë standarde futbollit me një sistem të duhur të kullimit dhe banka ku spektatorët mund të ulen. Gjithashtu kemi 300 metra trotuar dhe një klasë/teatër të hapur (në natyrë) ku jo vetëm që mbajmë mësim në natyrë gjatë verës, por është edhe sipërfaqe e cila shfrytëzohet edhe për shfaqje dhe koncerte. Nxënësit kanë pikturuar një mural në murin rrethues në njërin anë të shkollës me gjatësi prej 150 metra. Gjithashtu tani kemi edhe parking për makina. Gjyshërit me nipërit e mbesat e përdorni oborrit si park në fundjavë, bashkë me grupet që luajnë lojëra sportive në fusha, si dhe nënat gjatë pritjes së fëmijëve të tyre, si para ashtu edhe pas mësimit, i, i shfrytëzojnë këto hapësira.*

*“Kur e dëgjojmë fjalën MuSPP menjëherë e ndërlihim me punë të mirë dhe sigurisht që ajo ishte përvoja jonë këtu, dhe për këtë arsye ne do të përdorin këto teknika të mësuara nga MuSPP-i edhe gjatë realizimit të projekteve tjera. Ishte një gjë e mirë prezenca e një arkitekti dhe një monitoruesi në vendngjarje për të na mbajtur në rrugën e duhur për të prodhuar një produkt cilësor për komunitetin tonë,”*, përfundoi planeri komunal.

## Nga Planifikimi në Zbatim

### 'Juniku është Unik'

Juniku mund të jetë një komunë e re, por ka shtruar shumë rrugë drejt prezantimit të një qeverisje lokale dhe projektve më gjithëpërfshirëse prej të cilave përfitojnë komunitetet lokale, duke punuar gjithmonë në prapavijë me MuSPP-in në ofrimin e udhëzimeve dhe ekspertizës për të ndihmuar planerët dhe qytetarët e Junikut t'i arrijnë qëllimet e tyre.

Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuqi, sqaroi se *"bashkëpunimi i Komunës me MuSPP-in ka qenë shumë-dimENSIONAL. Plani ynë Zhvillimor Komunal (PZHK-ja) ishte i pari në Kosovë që është zhvilluar krejtësisht me kapacitete vetanake në komunë me ndihmën e zyrtarëve të MuSPP-it, dhe kjo është bazë për zhvillimin thelbësor strategjik në kuadër të komunës. MuSPP-i u ka dhënë planerëve tanë kapacitetet e nevojshme për aplikim të planifikimit hapësinor me pjesëmarrje për të mirën e gjithë komunitetit. PZHK-ja ka hapur mundësi të reja, të gjitha projektet e realizuara deri më sot burojnë nga PZHK-ja. Buxheti ynë është i bazuar në PZHK sepse ajo është pikënisje, ndikon në të gjitha drejtoritë, shërbimet publike, zhvillimin ekonomik, pylltarinë, turizmin dhe kulturën"*.



MuSPP-i prezantoi pilot Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM-në) për të testuar proceset në Junik pasi që ligji mbi VSM-në ishte miratuar më 2010.

Ferdone Tofaj, një nga planerët komunal theksoi se *"Juniku ishte vetëm një fshat i një komune tjetër, ai nuk kishte plane specifike. Prezantimi i planifikimit hapësinor ishte risi dhe diçka e shkëlqyeshme. Para MuSPP-it, teoria thoshte se komuna duhet të bëjë planet dhe t'i paraqiste ato si një "fakt i kryer". Tani qasja jonë është që komuniteti duhet të përfshihet nga fillimi i çdo plani hapësinor ose vlerësimi strategjik mjedisor. Ne e kemi "bërë qytetin tonë më të mirë së bashku"*.

I tërë koncepti i vizionimit ishte fascinues. Ferdones u bind për të kontribuar në punëtorinë e vizionimit..



*"Ishte goxha angazhim t'i kaloja 5 ditë në Ohër larg familjes sime, unë kam ndenjur në shtëpi e papunë duke u kujdesur për fëmijët e mi. Pas pjesëmarrjes në punëtorinë e vizionimit, isha e motivuar dhe e inkurajuar që të vazhdoja të jem pjesë e procesit. Kam filluar të punojë në komunë në Drejtorinë Urbanizmit si staf i ekipit për hartimin e PZHK-së. Pastaj u ftova në një konferencë ndërkombëtare në Vjenë ku prezentova rastin e Planifikimit Hapësinor në Junik. Ky ishte një ndryshim i shpejtë për mua, nga mos-njohia për planifikim në bërit pjesë e gjithë proceseve të projektimit dhe zhvillimit të PIK-ve, dhe zbatimit të mëtutjeshëm të PZHK-së dhe VSM-së."*

Koncepti i cili ishte hartuar në punëtorinë e vizionimit shkaktoi mjaft gjallërim kur ai iu prezantua komunitetit. Staf i komunal shkoi derë më derë për t'i informuar qytetarët dhe t'i ftojë ata në takim publik, duke kërkuar prej tyre të kërkonin prej miqve të tyre t'i tubonin njerëzit përmes metodës së 'topit të borës'.

Problemi i përfshirjes së sa më shumë grave u adresua përmes organizimit të një tryeze të rrumbullakët për gratë, por pyetja ishte se si të sjellëshin ato aty. Zgjidhja ishte të ftoheshin të gjitha gratë e stafit të komunës duke kërkuar prej tyre t'i sillnin shoqet e tyre, me ç'rast mbi 70 gra morën pjesë. Që nga ajo ditë, organizatat e tjera publike si ajo e gjuetarëve, shahistëve dhe OJQ-ve brenda komunitetit kanë përdorur qasje gjithëpërfshirëse me pjesëmarrje që është prezantuar për herë të parë nga MuSPP-i në projektet e tyre lokale.

*Jo vetëm që u krijuan lidhje ndërmjet komunës dhe komunitetit, por u krijuan lidhje edhe ndërmjet komunës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ministrive tjera të linjës. MuSPP-i ndihmoi në ngritjen e urave mes nesh në një mënyrë të butë duke trajtuar njësojë të gjithë pjesëmarrësit, duke mos marrur parasysh se prej nga vinë ata’.*

MuSPP-i mbajti një **kurs intensiv dhjetë ditor** për t’i aftësuar planerët se si ta përdornin **GIS-in**, dhe pas përfundimit të kursit, ata mund të hartonin harta duke përdorur GIS-in. Këto aftësi të reja do të përdoren për të hartuar hartat zonale që tani kërkohen sipas Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor të vitit 2013.

### **Dy Projekte të Investime Kapitale janë financuar bashkërisht nga MuSPP-i dhe komuna.**

I pari është oborri i shkollës. Procesi i PIK-ut është zhvilluar përmes përfshirjes së palëve kryesore të interesit në zhvillimin e projektit, si: nxënësit, prindërit, mësimmshënësit dhe aktivistëve të cilët kanë marrur pjesë në dy punëtori. Në punëtorinë e parë, disa propozime mbi vendndodhjen e projektit janë përgatitur përmes punës në grup. Përmes analizës SWOT janë identifikuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet.



Oborri i shkollës para zbatimit të PIK-ut.

Në punëtorinë e dytë ishin projektuar dy skenarë në bazë të punës dhe rezultateve të punëtorisë së parë. Amfiteatri ishte ideja e disa vajzave që morën pjesë aty. Sugjerimet e dhëna në punëtorinë e dytë ishin të kombinuara me ato të së parës. Skenari i fundit u zhvillua si rezultat i takimit të tretë. Ai u plotësua nga stafi komunal nën mbështetje të zyrtarëve të MuSPP-it, me të cilët është bashkëpunuar gjatë të gjitha fazave të hartimit dhe zbatimit të projektit. Projekti kaloi nëpër të gjitha fazat e aprovimit, diskutimit publik dhe projektimit përfundimtar. Zona sportive shumë-qëllimore përdoret nga i gjithë komuniteti, kurse amfiteatri përdoret kryesisht nga nxënësit e shkollave të komunës, për ceremonitë e ndarjes së çmimeve nga shkollat, për sfilata mode, koncerte, recitime, etj.



Rindërtimi i fushës sportive dhe oborrit të shkollës së mesme “Kuvendi i Junikut” projekti i zbatuar.

## Parku Moronica




PZHK-ja e Junikut dhe Plani përkatës i Veprimit ka identifikuar edhe Parkun Natyror Moronica si një zonë të interesit dhe bukuri natyrore që duhet të ruhet dhe të zhvillohet me kujdes. Ky zhvillim ishte subjekti i PIK-ut të dytë të realizuar në Junik.

Moronica është një nga peizazhet kryesore kodrinoro-malore, pasi që ajo shënon edhe fillimin e bjeshkëve të Junikut që shtrihen në jug-perëndim të Kosovës. Projekti i hartuar për Parkun Natyror Moronica ofron shtigje për këmbësorë dhe rekreacion brenda Moronicës, të pasuruara me elemente të tjera që mundësojnë lidhjen e qendrës së qytetit nëpërmjet urave për këmbësorë mbi lumin Erenik. Projekti është hartuar duke përdorur të njëjtën qasje me pjesëmarrëse, si në rastin e oborrit të shkollës, me komunitetin lokal, stafin komunal, Universitetin e Prishtinës dhe palët e tjera të përfshira. Projekti i ka kushtuar vëmendje të veçantë ruajtjes së mjedisit.

Ndikimi mbi komunitetin lokal ka bërë që më shumë vizitorë të vijnë në Junik dhe të përdorin shërbimet në qytet, dyqane, kafene, restorante, etj. Parku shfrytëzohet nga qytetarët vendas dhe ata të qyteteve fqinje që vijnë për shëtitje apo për aktivitete tjera në teatrin e hapur. Njerëz të të gjitha moshave vijnë për piknik, por dhe kur nxënësit e klasës së parë e përfundojnë abetaren, mësimmthënësit dërgojnë ata në park për piknik ku këndojnë dhe vallëzojnë përpara prindërve të tyre.



Teatri Natyror në Parkun Moronica





## PIK-u “Oborret e shkollave” në Rahovec

### Gjithpërfshirja në projekt

Qëllimi i PIK-ut ishte të ‘ndihmojë në krijimin e oborre të qëndrueshme të shkollave’. Të përfshira ishin dy shkolla ‘fituese’: një filllore, dhe një e mesme, kurse detyra e parë ishte krijimi i dy grupeve të punës të përbëra nga mësime, nxënës, prindërit, drejtorët e shkollave dhe stafi i komunës.



Bedri Hoti, një nga mësime dhe shkollës Hamëz Thaqi, i kualifikuar për projektim, i'u ndihmoi fëmijëve të paraqesin idetë e tyre në letër. *“Në një mënyrë të gjithë nxënës ishin të përfshirë, unë shkova në çdo klasë dhe i pyeta të gjithë për idetë e tyre dhe u kërkova atyre ta imagjinonin një oborr ideal për shkollën e tyre. Pastaj, i bëra bashkë nxënësit me idetë më të mira dhe i'u ndihmova atyre t'i vizatonin ato”.*



Një komision i përbërë nga stafi i komunës dhe MuSPP-i është formuar me qëllim të vlerësimit të ideve më të mira dhe më praktike, kurse stafi i komunës me ndihmën e zyrtarëve të MuSPP-it **ka punuar bashkarisht në projektim** çfar ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të tyre.

**Projekti** është prezantuar për **diskutim në të dy shkollat, ndërsa komentet** e pranuar nga 30 deri në 50 qytetarë në secilin takim janë regjistruar dhe sugjerimet e tyre janë integruar në projekt. Banorët e lagjes gjithashtu morën pjesë, pasi që edhe ata do të jenë përfitues të projektit. Procesi i diskutimit publik u përsërit edhe dy herë dhe në prezantimin e fundit morën pjesë rreth 200 qytetarë, shumë prej tyre nxënës të cilët dëshironin ta shihnin projektin përfundimtar.

Para dhe pas zbatimit



## Hani i Elezit - MuSPP-i mbështetë qasjen gjithëpërfshirëse

Në vitin 2009, Komuna e Hanit të Elezit dhe MuSPP-i nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit (MeM) për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHU). Qasja e hartimit me kapacitete vetanake në komunë e zgjedhur për hartimin e PZHK-së dhe PZHU-së së Hanit të Elezit ngriti kapacitetet e stafit të komunës. Gjatë procesit të hartimit, mungesa e hapësirave publike brenda zonës urbane të Hanit të Elezit u vu në pah si njëra prej çështjeve që duhej zgjidhur. Në diskutimet e mëvonshme, u dakordua që Projektet e Investimeve Kapitale (PIK) do duhej të trajtonin këto hapësira. Kjo ide është dërguar përpara, ndërsa komuna me ndihmën e ekipit të MuSPP-it realizoi një PIK. PIK-u për përmirësimin e hapësirave publike në Han të Elezit ishte projektuar me qëllim të përmirësimit të mjedisit të përgjithshëm në Han të Elezit si dhe për të shndërruar disa prej prioritetëve të planit në projekte konkrete të cilat do të shërbejnë qytetarëve.

Rufki Suma Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit shpjegon, *“Kur u zgjedha Kryetar i komunës në vitin 2009, stafi komunal tashmë ishte në proces të trajnimit për teknikën e planifikimit me pjesëmarrje, ndërsa hapësira qendrore e qytetit para ndërtesës së komunës nuk ishte fare mirëpritëse. Plani i Investimeve Kapitale i realizuar së bashku me MuSPP-in transformoi këtë zonë qendrore.*



Para zbatimit

*Shumë më tepër vlerë i është shtuar komunës gjatë periudhës së punës me MuSPP-in; proceset e menaxhimit, përkitazi me prezantimin e planeve hapësinore, janë shfrytëzuar në tërësi në komunën dhe tash kemi buxhet afat të shkurtër/mesëm. Tani punojmë më mirë. Kemi ndërtuar marrëdhënie të mira me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe kemi ndërlidhur me komunat tjera nga të cilat edhe kemi mësuar. Gjithashtu tani kemi edhe një VSM për të siguruar se vlerat mjedisore janë përfshirë në PZHK, dhe së fundmi kemi edhe planet për menaxhim të ujit dhe mbeturinave për komunën. MuSPP-i gjithashtu ka aftësuar planerët tanë në përdorimin e GIS-it, që na ndihmon gjithashtu edhe në prezantimin e hartave të reja zonale të kërkuara në bazë të Ligjit të Planifikimit Hapësinor të vitit 2013. Për të ndihmuar në sigurimin e transparencës, tani kemi publikuar edhe një vjetar i cili shtypet në kopje të mjaftueshme për çdo familje dhe media, i cili përshkruan punën e komunës gjatë vitit dhe i bën publike të gjitha shpenzimet e atij viti. Qeveria qendrore ka mirënjohur përpjekjet e komunës për të arritur transparencë në qeverisjen lokale”*



Pas zbatimit



Puna filloi me zell pas punëtorisë së vizionimit për PZHK-në e Hanit të Elezit i cili u miratua në vitin 2011. Gjatë gjithë procesit të planifikimit, zyrtarët e MuSPP-it kanë punuar me stafin komunal tashmë të përgatitur të vazhdoj planifikimin.

Zgjedhja përfundimtare për PIK.



## Prizren - Revitalizimi i Rrugës së Farkëtarëve

Ky Projekt i Investimeve Kapitale (PIK) u realizua nga MuSPP-i dhe Komuna e Prizrenit. U dakordua se parimi i gjerë për të mbështetur çdo projekt të investimeve kapitale, është integrimi i bërthamës së qendrës historike të Prizrenit (Shatërvani) me linjat kryesore të lëvizshmërisë rreth qendrës, me synim të përmirësimit të mjedisit të ndërtuar, pamjes së rrugëve nëpërmjet projektimit urban, aranzhimeve të lëvizshmërisë, dhe disa elemente të zhvillimit ekonomik, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje.



Zona Historike

Burimi: Plani i Konzervimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit

© Komuna e Prizrenit dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB)



Zona e Mbrojtur

MuSPP-i mbajti një punëtori vizionimi me një grup të gjerë të palëve të interesit nga Prizreni, ku ishte formësuar PZHK-ja deri më 2025. Kjo ishte hera e parë që një grup i madh i palëve të interesit nga Prizreni merr pjesë në planifikimin hapësinor për qytetin e tyre.

Znj Nora Arapi Krasniqi, në atë kohë studente, shpjegoi se deri në pjesëmarrjen saj në Punëtorin e Vizionimit, nuk kishte asnjë interes në planifikim. Tani ajo është arkitekte dhe menaxhon OJQ-në Trashëgimia Kulturore pa kufij (CHwB) në Prizren.



Plani Rregullues Urban është realizuar në kuadër të PZHK-së për të vendosur kufirin rreth Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit.

Gjatë hartimit të projektit, procesi i konsultimeve dhe pjesëmarrjes ishte jetik dhe kjo ka arsyetuar propozimin. Fillimisht ishte organizuar një shëtitje me palët e interesit rreth katër rrugëve në zonën historike dhe pastaj në punëtori, me ç'rast pjesëmarrësit plotësuan pyetësin e vizitës në teren. Pas analizimit të përgjigjeve nga ky pyetësor kanë rezultuar tri opsione. Si rrjedhojë, koncepti i revitalizimit të rrugës së farkëtarëve ishte zgjedhur për shkak të ndikimit në qendrën historike dhe të qytetit në tërësi.

Për këtë qëllim u krijua një bazë e shënimeve e të gjitha palëve të interesit brenda zonës që mbulon projekti, por edhe OJQ-të dhe mediat, me qëllim që secili prej tyre të jetë i njoftuar rreth zhvillimeve në projektin Rruga e Farkëtarëve. MuSPP-i, së bashku me planerët komunal, kanë hartuar një projekt për KIP-in, në baze të rezultateve të sondazhit. Janë mbajtur disa takime publike gjatë fazës së projektimit.




Z. Adnan Maloku, ishte njëri prej biznesmenëve lokal të përfshirë, i cili para realizimit të projektit kishte një dyqan për material ndërtimor në rrugën e Farkëtarëve. Rruga ishte në gjendje të mjerë, ndërtesat historike ishin në një gjendje të dobët, dhe zanatet e vjetra që karakterizonin atë nuk ishin më. Z. Maloku ishte i përfshirë në PIK që nga fillimi dhe shfrytëzoi rastin që të ndryshoj natyrën e biznesit të tij, nga shitja e materialit ndërtimor në një nga kafiteritë më të popullarizuar. Z. Maloku theksoi se, "Ky projekt më ka përmirësuar jetesën. Qasja e MuSPP-it për afrimin e të gjithë banorëve dhe

*bizneseve së bashku për të planifikuar të ardhmen e rrugës sonë ishte e re, mirëpo funksionoi, dhe të gjithë ne kishim ndjenjën e pronësisë së projektit. Gjatë fazës së realizimit, zyrtarët e komunës dhe MuSPP-it na vizitonin çdo ditë për të parë nëse jemi të kënaqur me atë se çka është bërë, njëkohësisht për të kontrolluar cilësinë e punës. Ne të gjithë kemi punuar bashkë për të arritur këtë rrugë që kemi tash. Banorët vendor dhe turistët tash po vijnë për çdo ditë në këtë rrugë dhe biznesi im i ri po ecën mirë. Tani është një zonë shumë e frekuentuar gjatë festivalit të filmit "Dokufest". Kjo rrugë tani është një vend i këndshëm për të ardhur ku njerëzit mund të shijojnë fasadat historike të cilat janë restauruar dhe të frekuentojnë kafiteritë e reja në zonën e këmbësorëve, ne kemi punuar shumë për të arritur ta shndërrojmë Rrugën e Farkëtarëve prej një parkingu të ndotur makinash në atë që është bërë sot."*

Njerëzit e kësaj zone historike, janë të njohur për qasjen me pjesëmarrje të MuSPP-it, sepse ata janë konsultuar dhe përfshirë në zhvillimin dhe restaurimin e Rrugës së Farkëtarëve. Pas përfundimit të projektit ishte realizuar një sondazh për të matur kënaqëshmërinë e qytetarëve. Rreth 86,42% të njerëzve që banojnë apo punojnë në zonën e projektit mendojnë se ky projekt ka rritur cilësinë



e jetesës, 85.43% e njerëzve mendojnë se përmirësimi në Rrugën e Farkëtarëve ka rritur sigurinë e njerëzve, dhe 76.82 % mendojnë se ky projekt ka inkurajuar bizneset e vogla. Gjithashtu u vlerësua lartë edhe cilësia e punimeve, siç mund të shihet edhe nga grafiku i më poshtëm.



Komuna e Prizrenit dhe MuSPP-i aktualisht janë duke realizuar edhe një projekt tjetër në Sheshin e Lidhjes së Prizrenit, të cilit i është qasur dhe i cili është organizuar në të njëjtën mënyrë dhe është afër përfundimit.

## Oborri i shkollës dhe këndi i lojërave në Radevë Komuna e Graçanicës

### Arsimi i transformuar për fëmijët serb, shqiptar dhe ashkali

Shkolla ishte në gjendje të keqe, me vrima të mëdha në kulm dhe pa strehë reale nga shiu. Kjo është një shkollë fillore ku e vetmja alternativë tjetër për arsim ishte rruga e gjatë deri në qytetin më të afërt. Rregullimi i objekteve arsimore ishte një nga prioritetet strategjike në PZHK-në e Komunës së Graçanicës. Komuna dhe MuSPP-i kanë punuar së bashku për të realizuar një PIK të bashkë-financuar kështu që shkolla dhe oborri të mund të rinovohen.



Këta fëmijë të vegjël së bashku me prindërit dhe mësuesit e tyre morën pjesë në një punëtori për të shfaqur idetë dhe vizionet e tyre për atë se çka i nevojitet kësaj shkolle. Kjo ishte hera e parë që të gjithë fëmijët ishin mbledhur në një klasë për të punuar së bashku, pasi që në zonat serbe të Kosovës, fëmijët shqiptar dhe serb mësohen nga mësuesit të ndryshëm në klasë të ndara. Përgjegjësia e MuSPP-it ishte rregullimi i oborrit, ndërsa e komunës shkolla. Bashkërisht u përpoqën t'i realizojnë ëndrrat e fëmijëve. Projekti i ilustruar më poshtë ishte zgjidhja e propozuar.



Tani ndërtesa e shkollës ka përfunduar, dhe fëmijët janë të kënaqur që kanë një shkollë të pastër dhe të ngrohtë. Puna në oborr është ende në zhvillim e sipër, mirëpo tashmë shtigjet janë finalizuar. Një nga fëmijët ka shpjeguar se këmbët e tij ishin përherë të lagura dhe me baltë para realizimit të këtij projekti. Së shpejti, shkolla do të ketë një fushe të vogël sporti në njërën anë dhe klasë në natyrë të stilit të hapur në pjesën e përparme. Shkolla do të bëhet më e sigurt kur të vendoset gardhi perimetrik. Gjithashtu do të ketë edhe një park në shfrytëzim për komunitetin.

Kujdestari Nexhmedin Qerkini theksoi se, *"Punëtorja ishte një ide e mire, gjithë idetë tona po bëhen realitet. Me parë, ishte vetëm një hyrje për të gjithë kurse tani janë 3 rrugë për qasje të automjeteve të shërbimeve dhe furnizimit, kështu që është më sigurt për fëmijët. Kishte aq shumë gropa në tokë saqë ishte e pamundur të luhej ndonjë lojë me top. Së shpejti fëmijët do të kenë fushën e sportit si dhe këndin e lojërave, ku të gjithë do të mund të luajnë"*.



## Ferizaj

Ferizaj është një qytet i madh në Kosovë dhe ishte një prej gjashtë komunave të para që MuSPP-i i ka mbështetur. Gjatë nëntë viteve të kaluara, Komuna e Ferizajt ka pasur shumë aktivitete me MuSPP-in, dhe disa nga më të rëndësishmet janë përshkruar më poshtë.


### Dokumenti i Planifikimit - Transporti Komponenta në kuadër të PZHK-së/PZHU-së

Kapitujt e transportit në kuadër të PZHK-së dhe PZHU-së së Ferizajt janë rezultat i analizës së çështjeve të transportit të komunës e cila përmban disa sugjerime solide mbi zhvillimin e infrastrukturës së transportit në qytet, dhe tërë komunën. Dokumenti është elaboruar në vitin 2011 nga MuSPP-i së bashku me Komunën e Ferizajt. Ky ishte një kontribut ndaj procesit të rishikimit dhe një elaborimi më i detajuar i PZHK-së dhe PZHU-së së Ferizajt, nga institucionet e saja demokratike dhe me pjesëmarrje të tërë shoqërisë civile. Çështjet e konsideruara në plan të transportit dhe plan përkatës të veprimit përfshijnë si në vijim:

- **Infrastrukturën e rëndësishë regjionale:** hekurudhat, aeroportet, varësinë nga veturat, devijimin e tranzitit dhe një qendër ambicioze të transportit, prioritetet e transportit publik.
- **Shërbimet e transportit publik:** në të gjitha zonat dhe në të gjitha nivelet
- **Lëvizshmërinë në vendbanime:** përfshirë nevojat e lëvizshmërisë dhe infrastrukturën e transportit lokal.

#### KONKURSI I PROJEKTIMIT URBAN

*Pas punëtorisë së vizionimit në vitin 2007, ishte lansuar një konkurs ndërkombëtar për dizajnin e lëvizshmërisë për Ferizajin. MuSPP-i ka ndihmuar në hartimin e Termave të Referencës dhe publikimin e konkursit ndërkombëtar përmes internetit. Në total kanë konkurruar 42 konkurrent, ndërsa MuSPP-i kishte organizuar dy komisione vlerësuese. Pas përzgjedhjes së listës së ngushtë, projekt-idea e një Australiani u përzgjedh si më e mira. Gjithashtu, u organizua një ekspozitë e të gjitha projekt-ideve konkurruese. Dizajni fitues është inkorporuar në PZHK dhe PZHU. Sidoqoftë, projekti nuk ka mundur të zbatohet në tërësi për shkak të kostos së lartë. Plani i Transportit i vitit 2011 sugjeron që projekti duhet të rishqyrtohet dhe të ndahet në disa pjesë më lehtë të menaxhueshme.*



Konkursi i Projektimit Urban

Konkursi i Projektimit Urban © Searle and Waldon Architects



## Projekti për Reduktimin e Përmbytjeve - Përmirësimi i shtratis të lumit Nerodime / Projekti i Investimit Kapital



Mustafë Zariqi, Udhëheqës i Njësisë së Planifikimit Urban, në Ferizaj, theksoi se; *“Ekipi i MuSPP-it na ka ndihmuar në të gjitha fazat e projektit. PIK-u ynë i parë ishte parandalimi i përmbytjeve, shtrati i lumit dhe brigjet e tij janë rregulluar, si dhe janë ndërtuar trotuarët dhe një urë”.*

Projekti ndërmori masa për parandalimin e përmbytjeve dhe përmirësimin e hapësirës përreth lumit, kështu duke e rritur zonën për kohezion social për të gjithë, për të rinjtë, të moshuarit, gratë, burrat, dhe grupet e cënueshme.

Pas përfundimit është rritur shfrytëzimi dhe përmirësuar mjedisi në këtë zone, është përmirësuar zona për këmbësorë, çiklizëm etj. Çështjet e pronësisë në zonë janë rregulluar, si dhe është instaluar ndriçimi në zonat e errëta për dukshmëri më të mirë dhe siguri gjatë natës.



Para dhe pas zbatimit





## Projekti i Korridorit të Gjelbër në Ferizaj

Koncepti i korridorit të gjelbër përbën ndërlidhje me hapësirat e gjelbra. Projekti ka ndihmuar në përmirësimin e hapësirave publike për qëllime sportive, civile dhe rekreative, me pajisje të duhura urbane, ndriçim dhe shtrim të trotuareve dhe rrugëve, me qasje të përshatëshme për të gjithë banorët dhe vizitorët. Cilësia mjedisore e përroit gjithashtu është përmirësuar, së bashku me cilësinë e ujit, për të promovuar qëndrueshmëri mjedisore, jo vetëm në zonën e përmirësimit, por edhe përgjatë lumenjve brenda tërë lagjës. Aspektet e lëvizjes për këmbësor dhe automjete në zonë, si dhe qasja për njerëzit me nevoja të veçanta gjithashtu është përmirësuar, duke i'u mundësuar qasje më të lehtë njerëzve me karroca.



## Mitrovicë

Projektet e investimeve kapitale në Mitrovicë janë inspiruar nga pjesëmarrësit në punëtorinë e parë të vizionimit, të organizuar nga MuSPP-i në Kosovë. (Shih Vizionimin)

Hysni Sylja, Zyrtar për marrëdhënie me media, në Komunën e Mitrovicës, ka punuar me komunën për shumë vite në role të ndryshme. Ai kishte bashkëpunuar me zyrtarët e MuSPP-it, të cilët kanë punuar në zyrat e komunës, gjatë dy fazave të para të MuSPP-it. Ai e ka përshkruar këtë si një eksperiencë të shkëlqyeshme, pasi që shumë ishte mësuar rreth qasjes me pjesëmarrjes në planifikim, si dhe disa PIK-ve të cilat ishin më rëndësi janë realizuar.



## Përmirësimi i Qasjes në shkollën fillore "Meto Bajraktari"

Projekti i parë i investimit kapital që MuSPP-i ka punuar me komunën ishte projekti **Përmirësimi i Qasjes në Shkollën Fillore "Meto Bajraktari"**. Shkolla është krejtësisht e rrethuar me rrugë. Nëntëqind e gjashtëdhjet e dy nxënësit e shkollës fillore ishin në rrezik nga lëvizjet e shpejta të trafikut çdo herë kur ata kanë hyrë apo dal nga shkolla dhe kanë ndodhur edhe aksidente. Komuna, zyrtarët në teren të MuSPP-it dhe ekspertët e trafikut, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, nxënësit, prindërit, Policia e Kosovës dhe përfaqësuesit nga Universiteti i Prishtinës, janë takuar të gjithë së bashku dhe kanë dhënë sugjerime dhe ide për zgjidhjen e këtij problemi. Kjo ka çuar në konsultime më të gjera rreth propozimit për vendosjen e pengesave më të mëdha në rrugë përreth shkollës për të ngadalësuar rrjedhjen e trafikut dhe qasjen më të lehtë të nxënësve në shkollë, e cila më pas është realizuar nga MuSPP-i dhe komuna.



Para dhe pas zbatimit

## Mitrovicë, Korridori i Gjelbër i Lumit “Lushta”

Siç është propozuar në PZH/PZHU: “Zonat përreth lumit përfaqësojnë zonat kryesore për pushim dhe rekreim për qytetin. Parqet e vogla dhe objektet sportive për kohë të lirë do të shpërndahen nëpër tërë qytetin. Rrjeti i brendshëm i rrugëve në qytet do të plotësohet me qëllim të lidhjes së zonave të shkëputura të vendbanimit”.

Projekti ‘Korridori i Gjelbër i Lumit Lushta’ ka filluar me procesin e auditimit dhe të projektimit të zonës me pjesëmarrje, procese të cilat janë zhvilluar dhe udhëhequr me komunën dhe palët e interesit nga shoqëria civile.

Njëra prej këtyre palëve të interesit ishte edhe Znj. Hilmijeta Apuk, fituese e çmimit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në vitin 2013, me OJQ-në e saj ‘Little People of Kosovo’.

Znj. Apuk theksoi se *‘Ka pasur probleme me qasjen brenda zonës së projektit të propozuar dhe se kjo është diskutuar në mbledhjet konsultative dhe është përfshirë në projekt.’*

**Znj Apuk shtoi se,** *“Zyrtarët në teren të MuSPP-it ishin gjithnjë të pranishëm në komunë dhe tek të cilët komuniteti i personave më aftësi të kufizuar ka mundur t’i drejtohet lidhur me çështjet të cilat janë ngritur dhe për të cilat e kanë ditur se do të merren veprime. MuSPP ka trajnuar stafin komunal të Drejtorisë së Urbanizimit lidhur me proceset e urbanizimit modern dhe akoma mund të shihni ndryshimin edhe sot. Sidoqoftë, kontributi më i madh i stafit të MuSPP-it ishte lidhja e tyre me komunitetin e personave më aftësi të kufizuar që ka çuar në pranimin e këtij komuniteti nga komuna dhe tani personat me aftësi të kufizuar gjithmonë përfshihen dhe konsultohen në projektet e ardhshme të infrastrukturës.”*

Para dhe Pas zbatimit



Projekti ‘Korridori i Gjelbër i Lumit Lushta’ ka optimizuar lidhjen duke krijuar jo vetëm lidhje koherente me qendrën e qytetit për këmbësorë/çiklistët dhe hapësirë cilësore publike por edhe një qasje pa pengesa për personat me nevoja të veçanta.



## Pejë - Sheshi Skënderbeu / Projekti i Investimit Kapital

### Transformimi i Qendrës së Qytetit të Pejës



Pas miratimit të Planit Zhvillimor Urban (PZHU-së) të Pejës në vitin 2007, MuSPP-i së bashku me Komunën e Pejës kanë formuluar një koncept për përmirësimin e hapësirave publike në qendrën e qytetit. Zona e parë e ri-projektuar ishte Korza, me ç'rast MuSPP-i ka ndihmuar komunën me mbështetje teknike në ri-projektimin e kësaj zone në vitin 2007-2008. Zona e projektit ishte zgjeruar dhe përfshinte edhe Sheshin Skënderbeu, dhe një projekt i ri i investimit kapital (PIK) ishte projektuar në vitin 2009.

### Lokacioni i Projektit

Moto e qytetit (e deklaruar në PZHU) "Peja, qytet i gjelbër dhe vital" ishte jetësuar me këtë projekt, i cili ka përmirësuar hapësirën për të gjithë: të rinjtë, të moshuarit, gratë, burrat dhe grupet e cënueshme. Është përdorur më tepër gjelbërim çfar ka përmirësuar cilësinë e mjedisit. Zonat për këmbësorë kanë përmirësuar cilësinë e ajrit dhe të jetës, duke reduktuar shkurret dhe duke përmirësuar sigurinë në zonat e errëta gjatë natës. Si rezultat, ky intervenim ka gjallëruar hapësirat publike dhe më shumë biznese janë hapur dhe ka përmirësuar jetën në ekonominë e zonës.



## Projekti i Investimeve Kapitale në Malishevë

Para dhe pas zbatimit - foto të urës



Malisheva është qyteti i ndarë në dysh nga lumi Mirusha, ku qendra e qytetit dhe stacioni i autobusëve janë në njërin anë të lumit dhe të gjitha shkollat në anën tjetër të lumit. Mënyra e vetme për të kaluar nga njëra anë në anën tjetër ishte një urë shumë e ngushtë dhe e rrezikshme. PIK-u synonte të zgjeroj dhe rinovoj urën si dhe të përmirësojë brigjet e lumit në të dyja anët e urës. Interesimi i banorëve, pjesëmarrës në proceset e planifikimit, siç është parë edhe në vendet të tjera, u rritë në mënyrë të konsiderueshme kur u bë e ditur se ekzistonte mundësia për një urë të re, e cila do të bënte udhëtimin e fëmijëve të tyre për në shkolla dhe prapa më të sigurt dhe do të përmirësonte qarkullimin e komunikacionit rrugor nga njëra anë e qytetit në tjetrën. Prindërit, nxënësit, bizneset dhe OJQ-të, të gjithë patën rast të merrnin pjesë në takimet publike mbi investimin të organizuara nga komuna së bashku me MuSPP-in. Ura e re është përfunduar dhe brigjet e lumit do të përfundohen së shpejti.

## Mamushë

### Punëtoritë e Vizionimit rezultuan me Oborr të Ri të Shkollës

Pas realizimit të në ankete për mbledhjen e të dhënave për PZHK dhe VSM dhe pas analizës përkatëse dhe punëtorive të realizuara, është hartuar një PIK për oborrin e shkollës. Në bazë të PIK-ut, ky oborr është ndarë në tri zona, **në zonën sociale, sportive-rekreative dhe arsimore**, siç shihet edhe më poshtë. Tanimë është e vështirë ta njohësh këtë vend pas përfundimit të PIK-ut me ndihmën e MuSPP-it.

Para dhe pas zbatimit



# MuSPP-i mbështetë partnerët vendor

## Trajnimet nga MuSPP-i duke shfrytëzuar 'Mekanizmat për ofrimin e trajnimeve të përshtatura'

Trajnimi ishte përsëritur gjatë gjithë programit:



*"Ndërgjegjësimi dhe ndikimi mjedisor nuk është bazë e vetme për trajnimin mbi VSM-në që e kemi kryer, por është bazë për të gjitha trajnimet tona, trajnimi nga MuSPP-i na ka dhënë një përvojë shumë të mirë gjatë zbatimit të PZHK-së dhe VSM-së."* Sulejman Dakaj, Drejtoria e Urbanizimit, Komuna e Rahovecit

*"MuSPP-i na ka përgatitur se si të përdorim GIS-in, krahas të gjitha trajnimeve të tjera që ne kemi pranuar nga MuSPP-i. Tani kolegët e mi janë të përgatitur mirë për të ofruar përvojat më të mira të planifikimit hapësinor, situatë e cila është shumë më e ndryshme nga gjendja që në të cilën ishim në vitin 2008, para se të fillonim të punojmë me MuSPP-në".* Miqail Vila, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Komuna e Hanit të Elezit



Luan Nushi, Drejtor i Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH) shpjegoi se *'Planerët tani mund të flasin për planifikimin. IPH-ja ofron një lidhje të vlefshme ndërmjet MMPH-së dhe komunave dhe i mundëson Ministrisë të jetë e informuar rreth asaj se çka po funksionon dhe çka jo. Instituti bashkon Ministrinë dhe Komunat dhe ofron perspektivë'*.

Palët kryesore për trajnimet e ofruara nga MuSPP-i janë **partnerët kyç të MuSPP-it**, si në vijim:

- MMPH-ja/IPH-ja
- MAPL-ja dhe ministritë e tjera të linjës
- AKK-ja
- Kryetarët e komunave
- Komunat
- OJQ-të
- Shoqëria Civile

MuSPP-i ka koordinuar aktivitetet edhe me partnerë të tjerë, si CHWB-në, FES-in, OSBE-në, për organizimin e kurseve të trajnimit.

MuSPP-i kanë ofruar një pjesë të madhe të trajnimeve, të cilat mund të ndahet në 4 kategori:

- Trajnimet me fokus në planifikimin hapësinor
- Trajnimet e ndëlidhura me planifikimin hapësinor
- Mbështetje për bashkëpunëtorët
- Përvojat ndërkombëtare për të pasuruar proceset e planifikimit në Kosovë.

Disa trajnime të përzgjedhura dhe karakteristikat përkatëse janë përshkruar në vijim:

## Trajnimet me fokus në planifikimin hapësinor

### Trajnimi për PZHK-në e parë të hartuar me kapacitete vetanake në komunë, në Kosovë

Nga viti 2009 deri në vitin 2011, MuSPP-i, IPH-ja/MMPH-ja, UN-Habitat-i dhe CHwB kanë qenë partnerë në hartimin e PZHK-së së Junikut (PZHK-ja e parë e hartuar me kapacitete vetanake në komunë), prandaj gjatë kësaj periudhe janë ofruar një varg i sesioneve të trajnimeve.

MuSPP-i gjithashtu ka përgatitur dhe ofruar modulet e trajnimit të paraqitura më poshtë, të përshtatura sipas nevojave të komunave si Hani i Elezit nga viti 2009-2012, Mamusha nga viti 2011-2012, si dhe Graçanica, Malisheva, dhe Parteshi nga viti 2012 deri në vitin 2013. Modulet e trajnimit ishin:

- E Punëtoritë e vizionimit
- Identifikimi i sfidave dhe përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për PZHK-në
- Zhvillimi i skenarit
- Plani i veprimit
- VSM-ja
- Përcaktimi i prioriteteve strategjike të PZHK-së

### MMPH-ja dhe IPH-ja kanë koordinuar dhe lehtësuar punën në grupe në bashkëpunim me MuSPP-in gjatë gjithë trajnimit për PZHK-në, PZHU-në si dhe çështjet ligjore

Lumnije Gashi e cila ka punuar në MMPH-në dhe tani punon në MuSPP në Prishtinë theksoi rëndësinë e trajnimeve të planifikimit strategjik hapësinor sipas qasjes me pjesëmarrje, të ofruar nga programet e UN-Habitat-it, të cilat kanë pasur ndikim në zhvillimin e saj profesionale. *“Unë i përkas një brezi ku sistemi i sistemi arsimor i planifikimit korrespondonte me sistemin e centralizuar të qeverisjes. Fillova të mësoj në lidhje me qasjen e planifikimit strategjik hapësinor me pjesëmarrje dhe aplikimin e parimeve përkatëse të planifikimit, përmes trajnimeve të ofruar nga programet e mëparshme të UN-Habitat-it, gjatë punës me MMPH-në. Pas angazhimit tim në kuadër të ekipit të MuSPP-it në vitin 2006, më është dhënë rasti t’i aplikoj njohuritë në praktikë, duke i dhënë mbështetje komunave në zhvillimin e planeve të tyre hapësinore dhe urbane”. Lumnija beson se arritja më e madhe e MuSPP-it është aplikimi i qasjes së bërjes me kapacitete vetanake në komunë, pra një qasje alternative për hartimin e PZHK-ve, PZHU-ve dhe PRRU-ve.*

Kjo qasje u aplikua fillimisht në Junik, në partneritet me CHwB-në dhe Institutin për Planifikim Hapësinor në kuadër të MMPH-së, ndërsa më pas edhe në Han të Elezit dhe komunat tjera partnere të MuSPP-it. Për më tepër, ky proces nxiti zbatimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të planit me qëllim që të ofroj një analizë që do t’i shtonte vlerë planit duke integruar komponentën mjedisore në të. Meqë ishte PZHK-ja e parë në Kosovë me VSM, ajo pati ndikim në nivelin qendror (MMPH-në) duke rritur përgjegjësinë e tyre në zbatimin e legjislacionit për VSM-në për të gjitha PZHK-të e ardhshme.

### Trajnimi për zbatimin e PZHK-ve dhe PZHU-ve

Në vitin 2012, të gjitha komunat partnere të MuSPP-it dhe përfaqësuesit e MMPH-së morën pjesë në kursin e trajnimit të MuSPP-it për dhënien e udhëzimeve se si të zbatohet PZHK-ja dhe PZHU-ja. Në këtë fazë shumica e komunave kishin miratuar PZHK-të dhe trajnimi përfshinte temat se si të hyhet në fazën e ardhshme, d.m.th. zbatimin. Sesionet punuese në grup u inkuadruan në punëtorinë mbi mënyrën se si secila komunë synonte të zbatoj planet e veta.

## Trajnimet e ndërlidhura me planifikimin hapësinor

### Trajnimi mbi VSM-në

Trajnimi mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor u ofrua nga MuSPP-i së bashku me MMPH-në për të gjitha komunat partnere të MuSPP-it në vitin 2014.

#### Trajnimi mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM-në) në Kosovë

Tetor 2014, Prishtinë

Si pjesë e procesit zhvillimit të së kapaciteteve për VSM-në, MuSPP-i ka ofruar një trajnimi dy-ditor mbi VSM-në për planet hapësinore, për zyrtarët e përfshirë në procedurat e VSM-së në nivel qendror dhe lokal. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të lansimit të udhëzuesit mbi procedurën e hartimit të VSM-së në nivel qendror dhe lokal.

Punëtorja kishte për qëllim rritjen e të kuptuarit dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin e VSM-së në aktivitetet e planifikimit hapësinor në Kosovë, si dhe adresimin e parimeve të përgjithshme të VSM-së, metodologjitë specifike, fazat dhe detyrat. Objektivi i punëtorisë ishte përmirësimi i të kuptuarit të pjesëmarrësve mbi dobitë dhe mundësitë e përdorimit të VSM-së si një vegël për vendim-marrje strategjike dhe për t'i mundësuar pjesëmarrësve përdorimin e VSM-së në mënyrë të pavarur në punën e tyre.



Punëtorja trajnuese mbi VSM-në

### Këshilla dhe Trajnim mbi Menaxhimin e Ujërave dhe Mbeturinave

Pas vizitës studimore në Estoni, ku morën pjesë përfaqësues nga komunat partnere të MuSPP-it dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Harju County Entrepreneurship and Development Consultancy (HEDC), në bashkëpunim me MuSPP-in, vizituan Kosovën në qershor të vitit 2014 **për të ofruar një punëtori trajnuese dhe të ofrojnë konsulencë, me theks të veçantë në zgjidhjet e trajtimit biologjik të ujërave të zeza.**



Plani lokal për menaxhim të mbeturinave të ngurta

Gjatë procesit të përditësimit të planeve lokale për menaxhim të mbeturinave të ngurta të Junikut dhe Hanit të Elezit, u realizuan vizita në teren, takime me palë të ndryshme të interesit dhe grupe punuese. Një punëtori ishte gjithashtu pjesë e aktiviteteve me qëllim të prezantimit të përvojave më të mira në menaxhim, planifikim, teknologjitë përkatëse dhe monitorimin e mbeturinave.



Planet lokale për menaxhim të mbeturinave të ngurta të aprovuar së voni, përfshijne edhe:

- Përmirësimin e shërbimeve të ofruara
- Promovimin i kompostimit
- Prezantimin e procesit të riciklimit
- Eliminimin dhe parandalimin e deponive ilegale
- Deponimin dhe shfrytëzimin e mbeturinave inerte

*“Ne po punojmë me MuSPP-in në disa fronte, prezantimin e planeve të përditësuara të menaxhimit të mbeturinave në disa nga komunat më të vogla, si Juniku dhe Hani i Elezit dhe kemi mbajtur punëtori mbi menaxhimin e mbeturinave në komuna tjera, si dhe me stafin e Ministrisë, me një ekspert nga MuSPP-i dhe zyrtarët e departamentit të mbeturinave nga MMPH-ja. MuSPP-i ka ndihmuar Ministrinë në Planin e saj të Menaxhimit të Mbeturinave si dhe duke komentuar mbi harmonizimin e ligjeve për mbeturina dhe ujëra. Vizita studimore në Estoni na prezantoi menaxhimin e mbeturinave në praktikë dhe çfarë e bën Estoninë me vlerë është se edhe ata kanë kaluar nëpër një periudhë të ngjashme të tranzicionit sikurse Kosova. Ne morëm shumë mësim gjatë vizitës studimore, si mbi: rehabilitimin shtratit të lumit; ndarjen e mbeturinave të mbledhura dhe riciklimin e tyre; trajtimin e ujit dhe trajtimin e ujërave të zeza. Të gjitha këto për të cilat ne jemi duke u përpjekur të tërheqim investimet në Kosovë.”* tha Enver Tahiri, Udhëheqës i Divizionit të Mbeturinave Kimike dhe Mbeturinave në Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.



### Trajnimi mbi GIS-in

Një kurs trajnimi pesë-ditor mbi GIS-in është mbajtur për stafin e të gjitha komunave partnere të MuSPP-it, i cili ka mundësuar aftësimin e tyre në përdorimin e këtij mjeti themelore për menaxhim të të dhënave dhe planifikim.

### Trajnimi mbi Indeksin e Qeverisjes Urbane

Në mbështetje të komunave partnere, MMPH-së, MAPL-së dhe AKK-së, MuSPP-i organizoi një punëtori trajnuese mbi Indeksin e Qeverisjes Urbane të zhvilluar nga UN-Habitat-i. Indeksi është duke u përdorur në nivel global për të demonstruar rëndësinë e qeverisjes së mirë në përmbushjen e objektivave të gjera të zhvillimit, ndërsa në nivel lokal, si ndihmon në identifikimin e pikave të forta të qeverisjes lokale dhe fushat për përmirësim, thelbësor për ngritje të cilësisë së qeverisjes. Punëtorja tregoi se pse dhe si të përdoret indeksi si një mjet i krahasimit dhe monitorimit drejt standardeve dhe performancës së përmirësuar krahas qytetarëve.

### Vendbanimet Joformale

MuSPP-i dhe OSBE-ja u bashkuan në mbështetje të MMPH-së dhe komunave për mbajtjen e një varg punëtorive, tryezave të rumbullakëta dhe konferencave me qëllim të lansimit të fushatës informative për vendbanimet joformale; ndër të tjera për identifikim të vendbanimeve joformale, për angazhim të komunitetit, dhe të rekomandimeve për zhvillimin e politikave përkatëse.



### Trajnimi mbi Integrimin Gjinor

Trajnimi gjinor konsiderohet të jetë thelbësor prandaj edhe është përfshirë gjatë gjithë programit.

Disa punëtori dhe trajnime janë ofruar, përfshirë nga një sesion mbi barazinë gjinore dhe gjithëpërfshirjen, në kuadër të çdo punëtorije të vizionimit.



### Trajnimi mbi Shndërrimin e Hapësirave në Vende

Ky trajnim ka ofruar shembuj praktik të zhvilluar në Kosovë dhe koncepte teorike në vendbërjen të kombinuar me përmes punëtorive të realizuara në komuna nga përvojat ndërkombëtare. Rezultatet më të rëndësishme, megjithatë, ishin identifikimi i hapësirave të rëndësishme të cilat do të mund të shndërrohen në vende më të gjallëruara nëpërmjet propozimeve konkrete se si kjo mund të arrihet si dhe procesi pjesëmarrës, duke dhënë hapësirë për diskutim me grupet përkatëse të interesit dhe ekspertët e planifikimit.

### Seminari "Symbio City" dhe Punëtorja Trajnuese

Qasja Symbio City është një kornizë konceptuale e mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm urban në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, bazuar në planifikimin me pjesëmarrje. Koncepti Symbio City u prezantua në një sesion trajnimi së bashku me shkëmbimin e përvojave lokale dhe rajonale në promovimin e zgjidhjeve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm.



## Mbështetje për bashkëpunëtorët

### Trajnimi mbi "Qasjen e Integruar për Përmirësimin e Zonave të Varfra Urbane", Izrael

Në vitin 2011, përfaqësuesit e MMPH-së dhe MuSPP-it ndoqën një trajnim një mujor në Izrael në Qendrën e Weitz-it për Studime Zhvillimore, të mbështetur nga Qeveria e Izraelit, mbi "Qasjen e Integruar për Përmirësimin e Zonave të Varfra Urbane".

### Programi global për student në udhëheqje dhe menaxhim të ndërmarrjeve

Si një femër aktive e komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptianë (RAE) në Kosovë, më ishte dhënë rasti të marrë pjesë në "Programin global për student në udhëheqje dhe menaxhim të ndërmarrjeve" në Kolegjin Manhattanville në Nju Jork. **MuSPP-i i'u kishte paraqitur organizatorëve** kandidaturën time për këtë program. Unë studioj psikologjinë; jam anëtare e një OJQ-je lokale të quajtur "Qendra për Integritim Ndërkombëtar" dhe anëtare e grupit punues për hartimin e Strategjisë së Qeverisë së Kosovës, për integrimin e Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptianëve.

Ky program gjashtë javor më dha besimin, aftësinë dhe njohuritë për tu bërë agjente për ndryshim në vendin tim dhe për të qenë zbatuese e një prej vizioneve të tij, për krijimin e një rrjeti mbarë botëror të femrave të reja që shërbejnë si udhëheqëse lokale. Diversiteti i femrave në këtë program më dha mundësi që të mësojë nga përvojat ndërkombëtare si dhe nga praktikatat më të mira nga e gjithë bota, si nga: Tanzania, Japonia, Zimbabveja, Kenia, Rumania, Brazili, Meksiko dhe Nigeria.

Njohuritë që fitova mbi menaxhimin e ndërmarrjeve dhe mbi çështjet e tjera janë më se të domosdoshme për të transformuar komunitetin tim, i cili edhe është një nga qëllimet e mia në të ardhmen. Unë po ashtu shpresoj se do t'i jap një shtytje avancimit të demokracisë në qytetin tim, në Gjakovë, dhe në përgjithësi në vendin tim.

Mimoza Gavrani,  
Member of the NGO 'Centre for International Integration'

## Përvojat Ndërkombëtare për të pasuruar Proceset e Planifikimit në Kosovë

### Vizitë Studimore në Suedi, në vitin 2007

Urbanizimi dhe rigjenerimi, riciklimi, zhvillimi dhe rregullimi i zonave të veçanta urbane në qendrën historike të qytetit, si dhe sistemet e qëndrueshme të trafikut ishin disa nga çështjet mbi të cilat pjesëmarrësit fituan njohuri.



### Vizitë Studimore në Suedi, në vitin 2010

Pjesëmarrësit u familjarizuan me sistemin Suedez të qeverisjes lokale, funksionin, rolet dhe përgjegjësitë e tij. Thëks i veçantë i është kushtuar zhvillimit hapësinor strategjik, çështjeve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisor dhe lidhjen e tyre me zhvillimin e qëndrueshëm.



Pjesëmarrësit arritën në përfundim se edhe pse Kosova nuk ka në dispozicion të njëjtin nivel të burimeve dhe ekspertizës, shumica e "praktikave më të mira" të vëzhguara, duhet të merren parasysh dhe zbatohen në nivelin e duhur në Kosovë.

### Vizitë Studimore në Suedi, në vitin 2011

Vizita studimore kishte për qëllim njohjen më të mirë të pjesëmarrësve me sistemin Suedez të planifikimit dhe zbatimin praktik të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.



### Vizitë Studimore në Greqi, në vitin 2013

MuSPP-i ka sjellë specialistë të banimit dhe të menaxhimit urban nga Kosova në Selanik, me ç'rast pjesëmarrësit fituan njohuri nga përvoja greke në trajtimin e vendbanimeve joformale.

### Vizitë Studimore në Estoni, në vitin 2014



Pjesëmarrësit u takuan me anëtarët e Komisionit për Mjedisit të Parlamentit të Estonisë për të diskutuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e përvojave mbi çështjet e mbrojtjes së mjedisit, ujit dhe ujërave të zeza.



Gjatë qëndrimit, janë zhvilluar edhe vizita në objekte dhe lokacione të projekteve të ndryshme për menaxhimin e infrastrukturës së gjelbër, mbeturinave dhe menaxhimit të ujërave të zeza në tri komuna me qëllim të demonstrimit të mundësive për turizëm të qëndrueshëm, menaxhim të mbeturinave dhe rregullim të trafikut, rinovimin e impianteve të pastrimit biologjik dhe projektit për rregullimin e lumit, etj., si përgjigje ndaj sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Të pranishëm ishin edhe planerët nga Rahoveci, të cilët morën informacione shumë të dobishme që do t'iu ndihmojnë atyre në zhvillimin e planit të tyre për menaxhimin e ujit dhe ujërave të zeza.

### **Konferenca mbi Kohezionin Territorial, e zhvilluar në Amsterdam në qershor të vitit 2006 përkitazi me Perspektivën Evropiane për Planifikimin Hapësinor, të mundësuar nga Strategjia e Lisbonës 2000**

Ekipi i MuSPP-it dhe MMPH-së që mori pjesë në konferencë prezantoi rezultatet dhe dha një sërë rekomandimesh për Kosovën.

### **Konferenca Rajonale mbi Qeverisjen e Mirë Urbane, në vitin 2006**

Qëllimi i kësaj konference ishte prezantimi i mjeteve për Qeverisje të Mirë dhe shembujve të praktikave të Qeverisjes së Mirë Urbane nga Kosova dhe vendet tjera të rajonit, në kontekstin e planifikimit, zhvillimit dhe revitalizimit të qyteteve duke përdorur praktika të shëndosha.

### **Konferenca mbi Banimin Social në Serbi, e zhvilluar në Beograd, në vitin 2006**

Stafi i MMPH-së dhe MuSPP-it morën pjesë në një konferencë në Beograd, në vitin 2006, e cila ofroi mundësinë për tu njohur me politikat specifike kombëtare që adresojnë nevojat e banimit të grupeve me të ardhura të ulëta.

### **Takimet Rajonale për Shqyrtimin e Deklaratës së Vjenës, nga viti 2006 deri në vitin 2010**

MuSPP-i ka lehtësuar pjesëmarrjen e rregullt të Institucioneve të Kosovës në Takimet Rajonale për Rishqyrtimin e Deklaratës së Vjenës (shih Vendbanimet Joformale). Në vitin 2010, Integrimi i Vendbanimeve Joformale ishte tema kryesore që u prezantua në takim, ndërsa projekti i Vendbanimit Joformal Zatra u prezantua gjatë sesionit të rastit studimor.

### **Kongreset e ISOCARP-it**

Në Kongresin e 42 të ISOCARP, të zhvilluar në Stamboll, u prezantuan dy raste studimore mbi Mitrovicën, të cilat ilustruan parimet e planifikimit të prezantuara nga MuSPP-i; ndërsa përfaqësuesit nga Kosova morën pjesë edhe në Kongresin e 45 të ISOCARP-it "Qytetet me Karbon të Ulët" në Porto, Portugal, në tetor të vitit 2009.

## **Rrjetëzimi ndërmjet Nivelit Qendror dhe Lokal**

**MuSPP-i ka luajtur një rol aktiv në lehtësimin e shkëmbimit të eksperiencave, rrjetëzimin ndërmjet komunave, si dhe në inkurajimin e dialogut ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.**

### **Punëtorja e Kryetarëve të Komunave, nga 26-29 mars 2013, në Stamboll, Turqi**

Qëllimi i kësaj vizite ishte diskutimi i bashkëpunimit ekzistues ndërmjet MuSPP-it, MMPH-së, AKK-së dhe komunave partnere dhe vlerësimi i progresit të tanishëm në aspektin e politikave dhe programeve. Ky takim ofroi mundësinë për shkëmbimin e përvojave me Asociacionin e Komunave Turke.

### **Punëtorja me komunat partnere, nga 19-20 mars 2014, në Ohër, IRJM**

#### **Ku jemi? Ku dëshirojmë të shkojmë dhe si?**

Që nga punëtorja komunale e fundit, ishin mbajtur zgjedhjet lokale dhe kishte shumë fytyra të reja prezente. Në punëtori morën pjesë 12 komunat partnere të MuSPP-it; si dhe komunat e Zveçanit, Leposaviqit, Mitrovicës së Veriut dhe Zubin Potokut. Kjo ishte një mundësi për MuSPP-in për të prezantuar gjendjen aktuale të Programit, si dhe për MMPH-në për të prezantuar kornizën e re ligjore të Planifikimit Hapësinor. Përveç shkëmbimit të përvojave, kjo punëtori ofroi një mundësi të favorshme për ndërtimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të koordinimit dhe dialogut të vazhdueshëm ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes mbi tema e ndërlidhura me planifikimin hapësinor.

### **Konferenca mbi 'Gjendjen Aktuale të Planifikimit të Zhvillimit Komunal/Urban', në vitin 2007**

Në vitin 2007, MuSPP-i organizoi një konferencë me AKK-në dhe MMPH-në për të promovuar praktikën e mira dhe për të fituar njohuri nga rastet studimore në Komunën e Pejës për përfaqësuesit e qeverisë lokale dhe qendrore si dhe palët e interesit.

### **Konferenca mbi 'Transportin e Qëndrueshëm Publik dhe Planifikimin Hapësinor', në vitin 2007**

MuSPP-i organizoi një konferencë që u fokusua në infrastrukturën themelore dhe transportin jo të motorizuar në planifikimin hapësinor për Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT-në), MMPH-në dhe AKK-në.

# MuSPP-i - Këshilltar i besueshëm

## Këshillat ligjore dhe mbështetja për tërë legjislacionin e ri lidhur me planifikimin hapësinor

Në vitin 2010, u amendamentua Ligji për Planifikimin Hapësinor për të përfshirë në kuadër të PZHK-së edhe zonat e veçanta të mbrojtura si dhe hyri në fuqi Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. MuSPP-i ka kontribuar në këto procese ligjore. Ligji i ri për Planifikimin Hapësinor ka hyrë në fuqi në vitin 2013. Ky ligj synon të thjeshtëzojë procedurat e planifikimit. Ai është i lidhur ngushtë me Ligjin e ri të Ndërtimit i cili u publikua në gazetën zyrtare në vitin 2012 dhe Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje i cili hyri në fuqi në vitin 2014. **MuSPP-i mori pjesë në komisionin funksional parlamentar për mjedisin, bujqësinë dhe planifikimin hapësinor** i cili ka hartuar të tri këto ligje. Përmes këtij procesi, MuSPP-i ofroi rekomandimet teknike mbi zbatimin e planeve hapësinore të cilat kanë ndihmuar në formulimin dhe përmbajtjen e ligjit të ri.

### Pilot-projekti për hartimin e PZHK-së së Malishevës sipas Udhëzimit Administrativ të dalë nga Ligji për Planifikim Hapësinor i vitit 2013

Në Malishevë janë duke u zhvilluar aktivitetet nga MuSPP-i së bashku me planerët komunal mbi testimin e Udhëzimit Administrativ për PZHK-në, të dalë nga Ligji për Planifikimin Hapësinor i vitit 2013. Ky është një pilot-projekt që do t'i mundësojë Malishevës të informojë MMPH-në për përdorimin praktik të procesit të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për PZHK-në. Mbështetja është duke u ofruar përmes grupeve të dedikuara të punës, të cilat përbëhen nga zyrtarë të MMPH-së, MuSPP-it, USAID dhe projektit të financuar nga BE-ja mbi planifikimin hapësinor rural.

PZHK-ja e Malishevës mund të bëhet PZHK-ja e parë e harmonizuar me kornizën e re ligjore mbi planifikimin hapësinor.g.


Prezantimi i PZHK-së në Malishevë



## Plani hapësinor i parkut kombëtar - Vlerësimi strategjik mjedisor, Parku Kombëtar "Bjeshkët E Nemuna"

MuSPP-i ka ofruar shërbime këshilluese për Institutin e Planifikimit Hapësinor në procesin e hartimit të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Harmonizimi i kërkesave për ruajtje dhe kërkesave për zhvillim në këtë zonë të madhe sigurisht se ishte një sfidë. Në këtë perspektivë, MuSPP-i solli në proces ekspertizën ad-hoc të pasur me një përvojë aktive të planifikimit hapësinor dhe menaxhimit të një parku kryesor kombëtar. Janë dhënë kontribute të rëndësishme në drejtim të qasjes me pjesëmarrje ndaj planit hapësinor, formulimit të skenarëve për kornizën e zhvillimit hapësinor, zonimit, dhe identifikimit të aktiviteteve. Janë dhënë shembuj konkret në lidhje me atë se çfarë funksionon dhe çfarë jo. Është mbajtur një seri e punëtorive dhe tryezave të rrumbullakëta me ekipet komunale, banorët dhe bizneset e pesë komunave në kuadër të parkut, si dhe me alpinistët, OJQ-të dhe grupet e tjera të interesit. Plani hapësinor për Parkun Kombëtar ishte i pajisur me informata edhe nga Studimi i Fizibilitetit

dhe nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Grykën e Rugovës që ishin zhvilluar paralelisht nga MuSPP-i, dhe që kanë ofruar informata relevante dhe konkrete për zhvillimin dhe masat mbrojtëse mjedisore.



## Vendbanimet joformale

Vendbanimet joformale janë një çështje e vështirë që nuk është karakteristike vetëm për Kosovën. Megjithatë, të përcaktuarit se çfarë përbën një zgjidhje joformale mund të ndryshojnë nga vendi në vend. UN-Habitat-i ka mbështetur MMPH-në në të gjitha përpjekjet e saj për të filluar trajtimin e këtij problemi si para ashtu dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së MuSPP-it. Vendbanimet joformale janë vendbanime njerëzore të cilat nuk u ofrojnë banorëve të tyre mundësinë për të gëzuar të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm jetese. Vendbanimi joformal karakterizohet si vendbanim i paplanifikuar, me banim joformal apo të pasigurtë dhe pjesëmarrje jo-adekuate apo mos-pjesëmarrje në qeverisje. Kjo rezulton me një mungesë të shërbimeve bazë, regjistrimit, dhe infrastrukturës. Ajo gjithashtu çon drejt diskriminimit të banorëve<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Sipas përkufizimit në ligjin Nr. 03/L-106 për amendamentimin dhe plotësimin e Ligjit, Nr. 2003/14

Në vitin 2005, **Kosova nënshkroi Deklaratën e Vjenës për Vendbanimet Joformale**, që bën thirrje për parandalimin e vendbanimeve të reja joformale dhe rregullimin e atyre ekzistuese. Parandalimi dhe rregullimi i vendbanimeve joformale është përfshirë edhe në Planin për Implementimin e Standardeve të Kosovës (PISK) dhe pasardhësin e tij, Planin e Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Çështja e vendbanimeve joformale është gjithashtu pjesë e rëndësishme e progresit të Kosovës drejt përbushjes së Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit. Me rëndësi të veçantë janë masat e veçanta për të adresuar nevojat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në vendbanime joformale, të cilët janë zhvendosur si pasojë e konfliktit.

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit për Planifikim Hapësinor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përkrahur përmirësimin e vendbanimeve joformale për shumë vite. Duke qenë se më parë ka punuar si planere në Gjakovë, Suzana ka parë ndryshimet që MuSPP-i i ka bërë që nga fillimi. *“UN-Habitat-i ka prezantuar një mënyrë të re të tëmënduarit dhe na ka ndihmuar të identifikojmë prioritetet strategjike për PZHK-të. Tani të gjithë palët lokale të interesit janë të përfshirë dhe është e domosdoshme të ketë konsultime për të gjitha planet e secilit nivel. Unë kam punuar me MuSPP-in në të gjitha aktivitetet për përmirësimin e vendbanimeve joformale, kam udhëhequr Grupin Punues për vendbanimet joformale të përbërë nga këshilltarë dhe përfaqësues të MMPH-së, AKK-së, OSBE-së, dhe MuSPP-it. Gjithashtu kam mbështetur nënshkrimin e Deklaratës së Vjenës nga Kosova dhe kam përfaqësuar Kosovën në takimet shqyrtuese të Deklaratës së Vjenës; Kam qenë në konferencat për vendbanimet joformale në Nairobi dhe Selanik dhe në Forumin Botëror Urban në Vankuver. E gjithë kjo përvojë në çështjet e vendbanimeve joformale nënkupton se kam qenë në gjendje të luaj një rol të madh në konceptimin e udhëzimeve, broshurave dhe fletëpalosjeve mbi Vendbanimet Joformale, të cilat i ka prodhuar MMPH-ja dhe jam e kënaqur që PIK-u i parë tanimë ka përfunduar në vendbanimin joformal Zatra në Pejë.”*



*Kam qenë në konferencat për vendbanimet joformale në Nairobi dhe Selanik dhe në Forumin Botëror Urban në Vankuver. E gjithë kjo përvojë në çështjet e vendbanimeve joformale nënkupton se kam qenë në gjendje të luaj një rol të madh në konceptimin e udhëzimeve, broshurave dhe fletëpalosjeve mbi Vendbanimet Joformale, të cilat i ka prodhuar MMPH-ja dhe jam e kënaqur që PIK-u i parë tanimë ka përfunduar në vendbanimin joformal Zatra në Pejë.”*

Në fillim të nëntorit të vitit 2006, MuSPP-i organizoi një seminar mbi “Avancimin dhe rregullimin urban të vendbanimeve joformale”, së bashku me MMPH-në dhe OSBE-në. MuSPP-i përgatiti një material për diskutim të titulluar “Përmirësimi i Vendbanimeve Joformale”. Ky dokument identifikon dispozitat ekzistuese ligjore për trajtimin e çështjes së vendbanimeve joformale në Kosovë. Ai gjithashtu hulumton modelet e mundshme për ndërhyrje hapësinore në lidhje me vendbanimet joformale. Si vazhdimësi e punëtorisë, është përgatitur një punim i përbashkët me rekomandime për Qeverinë e Kosovës, i quajtur “Komunat dhe banorët e vendbanimeve joformale”.

Së bashku me MMPH-në, MuSPP-in, dhe OSBE-në si palë kryesore, në shtator të vitit 2007 është themeluar një grup punues për vendbanimet joformale për iniciimin e një procesi të diskutimit të gjerë dhe të integruar që çon në formulimin e një “Strategjie dhe Plani Kombëtar të Veprimit për Vendbanimet Joformale”. MuSPP-i ka vazhduar të këshillojë MMPH-në edhe në vitin 2013, gjithashtu ka organizuar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Departamentit për Planifikim Hapësinor dhe Departamentit të Banimit në kuadër të MMPH-së dhe të komunave partnere të MuSPP-it në një vizitë studimore mbi Vendbanimet Joformale në Selanik, Greqi. Qeveria e Kosovës ka zhvilluar masat e politikës duke u fokusuar në integrimin e 174 vendbanimeve joformale të identifikuar në Kosovë në sistemin formal të planifikimit hapësinor, duke synuar rregullimin e plotë të vendbanimeve joformale deri në vitin 2015, siç është dakorduar në Deklaratën e Vjenës. Ky proces është përfshirë edhe në procesin e reformave strukturore të projektuar ashtu që të çojnë Ballkanin Perëndimor drejt anëtarësimit përfundimtar në Bashkimin Evropian.



## MuSPP-i mbështet projektin e parë të investimeve kapitale për një Vendbanim Joformal në Pejë

**Zatra** sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHU) ishte identifikuar si një nga vendbanimet joformale dhe si projekt prioritar në Komunën e Pejës.

**Historia e banimit joformal** - Që nga viti 1920, pronat në këtë zonë ishin një përzierje e pronave private, pronave në pronësi të shtetit dhe ndërmarrjeve shoqërore. Pronat private në këtë zonë kryesisht i përkisnin komunitetit serb. Ndryshimi i pronësisë filloi pas Luftës së Dytë Botërore, kur shqiptarët i blenë këto prona. Ndërtimi filloi në vitet e 1950-ta, me shtëpi individuale në prona të mëdha ku ndërtimet bëheshin pa leje. Gjatë viteve 1970-ta, pati një rritje të ndryshimit të pronarëve nga serbët tek shqiptarët dhe uzurpim të pronave publike. Vendbanimi joformal Zatra është pranë një ish-baze ushtarake jugosllave, dhe për shumë vite, zona ishte bosh.

Plani i veprimit i integruar në Planin Rregullues Urban të Zatrës (PRrU, 2011) parashikoi ndërtimin e katër rrugëve, ndërsa Bulevardi i Gjelbër i Zatrës ishte një prej rrugëve të propozuara në PRrU për vendbanimin joformal të Zatrës. Bulevardi i Gjelbër në lagjen Zatra është një zonë që përbëhet nga shtegu i gjelbër që lidhet me qendrën e Pejës përmes shtigjeve për këmbësor dhe çiklist përgjatë parkut të qytetit, të cilat kalojnë nëpër lagjen e Zatrës, përgjatë bregut të lumit në anën e kundërt të Patriarkanës së Pejës dhe lidhet me Grykën e Rugovës dhe shtegun e gjelbër të Parkut Kombëtar. Bulevardi i Gjelbër i Zatrës përforcon edhe më tej rrugën e gjelbër të Pejës, e cila në vetvete është pjesë e projektit ndër-kufitar Majat e Ballkanit për promovimin e turizmit alternativ.

**Njoftimi me njerëzit dhe fitimi i besimit të tyre - OJQ-ja Syri i Vizionit** e cila konsiderohej si organizatë neutrale, në partneritet me Komunën e Pejës dhe zyrën e MuSPP-it në Pejë, ka lehtësuar komunikimin me banorët e vendbanimit.

*'Detyra e parë ishte që të krijohen marrëdhëniet me komunitetin dhe t'u jepet njerëzve mundësia që të marrin pjesë në planifikimin e përmirësimeve në vendbanim. Syri i Vizionit ka diskutuar planet me familjet për të ndërtuar besimin, duke shpjeguar*

*e shtëpitë e tyre mund të legalizohen, në mënyrë që ata të kenë më shumë qasje në shkolla dhe shërbime publike. U aranzhuan takimet e lagjes, u vizatuan disa harta, u morën parasysh përparësitë dhe mangësitë si dhe u arritën kompromiset. 'Ne kemi krijuar diçka që mund të bëhet realitet. Kemi punuar së bashku me MuSPP-in në zonat e ndryshme në këtë proces të integruar'. Veton Mujaj, Drejtor Ekzekutiv, shpjegoi se:*

Vendndodhja e projektit Bulevardi i gjelbër i Zatrës



- Me banorët e Zatrës janë mbajtur takimet informuese për të diskutuar nevojat dhe problemet e popullatës dhe se si këto probleme dhe sygjerrime mund të inkorporohen në PRRU, në mënyrë që të përfshihen në perspektivën afatgjatë.
- Vlerësimi i situatës përmes analizës SWOT ka çuar në ndryshime që janë bërë në punëtori, ku janë përzgjedhur temat si banimi, mjedisi, infrastruktura, punësimi, zhvillimi ekonomik, sporti, turizmi etj. Rezultatet e kësaj analize janë përdorur gjatë hartimit të planit urban.
- Janë zhvilluar pyetësorë të veçantë për mbledhjen e të dhënave në secilën prej 350 familjeve në këtë lokalitet. Të dhënat e mbledhura në pyetësorë janë organizuar dhe janë futur në bazën komonale të të dhënave.




Modest Gashi nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Pejës shpjegoi se çfarë do të thotë ky projekt për Zatrën.



*“Me këtë projekt, janë përmbushur disa nga synimet për rregullimin e vendbanimit joformal Zatra. Kjo zonë është përmirësuar me të gjitha elementet e përcaktuara në këtë PIK. Lagjja është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Ajo tani është e integruar në sistemin urban dhe ka një infrastrukturë të re rrugore. Zona gjithashtu ka përmirësuar lidhjen dhe shërbimet themelore urbane siç është kanalizimi. Gjithashtu, edhe imazhi i saj ka ndryshuar me gjelbërimin e inkorporuar dhe është rritur siguria për fëmijët dhe të gjithë banorët e tjerë.”*

Zatra para dhe pas zbatimit



## Hartimi i udhëzuesve nga MuSPP-i

MuSPP-i ka hartuar udhëzues për të gjitha aspektet kryesore të planifikimit hapësinor. Disa nga ato, të cilat ishin të dedikuara për çështje të veçanta, janë shpërndarë gjatë punës. Tani udhëzuesit janë duke u përmbledhur në Përmbledhjen e udhëzuesve praktik të MuSPP-it, i cili mund të përdoret nga kosovarët në mënyrë të vazhdueshme, dhe i cili është gjithashtu i rëndësishëm për përdorim ndërkombëtar.

**Përmbledhjen e udhëzuesve praktik të MuSPP-it: Udhërrëfytyrë ynë për vetëqëndrueshmëri** ka për qëllim t'ia mundësojë vendimmarrësve të nivelit lokal dhe qendror, OJQ-ve dhe përfaqësuesve të komuniteteve lokale të njihen edhe më tej me metodologjitë e ndryshme më të përshtatshme për kontekstin e zhvillimit të tyre në mbështetje të proceseve të planifikimit hapësinor.

Udhëzues të përzgjedhur janë prezantuar në vijim.

### Doracaku mbi Vizionimin

Doracaku ofron një kuptim më të mirë për rolin dhe procesin e Vizionimit si një mjet i planifikimit me pjesëmarrje. Doracaku shqyrton në thellësi nocionin "vizionimi i komunitetit" me disa parime, instrumente dhe udhëzime, të bazuara kryesisht në literaturë ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë. Përshkruan mënyra të ndryshme dhe hapat për të organizuar një ushtrim apo punëtori të vizionimit, përfshirë këtu edhe metodat dhe teknikat moderne me rezultate të dëshmuara. Dokumenti gjithashtu paraqet praktikën e Vizionimit në Kosovë duke hulumtuar rezultatet dhe implikimet e tërthorta për autoritetet dhe përfituesit e planifikimit, dhe në fund nxjerr mësim mbi "pse, si, dhe çfarë, për cilat rezultate?"



### Udhëzuesi mbi Integrimin Gjikor në Planifikimin Hapësinor

Udhëzuesi promovon një qasje për integrimin gjikor në praktikën e planifikimit hapësinor në formën e një metodeje hap pas hapi për komunitet. Në mënyrë fleksibile dhe jo-përshkruese, udhëzuesi përshkruan dhe ilustron mënyrat e ndryshme dhe fazat për të përfshirë perspektivën gjikore në proceset e planifikimit në aspektin e politikave dhe zbatimit të tyre. Udhëzuesi gjithashtu jep shembuj të rasteve studimore nga komunitet e Kosovës dhe përshkruan disa nga mësimet e nxjerra, në të cilat është e bazuar përmbledhja e rekomandimeve për integrimin gjikor. Udhëzuesi demonstroi praktikisht pse dhe si të përfshihen gratë dhe vajzat, si dhe burrat dhe djemtë me qëllim të rritjes së gjithëpërfshirjes, demokracisë lokale dhe transparencës, si thelbësore për hartim të politikave dhe projekteve të përgjegjshme.



### Udhëzuesi mbi Pjesëmarrjen Publike në Planifikimin Hapësinor

Udhëzuesi mbi përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e planifikimit hapësinor janë të dedikuara kryesisht për anëtarët e institucioneve qeveritare qendrore dhe lokale që do të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor me metodën me pjesëmarrje, gjithëpërfshirje dhe të ndryshme gjikore. Ai gjithashtu ka për qëllim zhvillimin e njohurive dhe kapaciteteve të atyre që punojnë në fushën e qeverisjes urbane dhe planifikimit të qyteteve, duke përmirësuar dhe ndihmuar për të institucionalizuar qasjet e tilla me pjesëmarrje.

Udhëzuesi mund të shërbejë si burim informacioni edhe për palët tjera të interesit. Ai është pjesë e një dokumenti gjithëpërfshirës që ka të bëjë me kërkesat ligjore të dokumenteve të planifikimit hapësinor, siç parashihet në Ligjin për planifikim hapësinor dhe aktet e shoqëruara nënligjore. Qëllimi është bërja sa më praktike e këtyre udhëzuesve, por edhe për ofruar informacione të cilat mund të jenë të dobishme për ata që nuk kanë pasur mundësi më parë të punojnë në çështjet e pjesëmarrjes publike.



## Udhëzuesi për hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale (PZHK-ve)

Udhëzuesi jep direktiva për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHKsë) në prag të lindjës së Ligjit të ri për Planifikimin Hapësinor të vitit 2013. Ai është zhvilluar si një orientim për komunitetet e Kosovës, bazuar në mbështetjen dhe përvojën me komunitetet partnere dhe kontekstet specifike të MuSPP-it. Dokumenti përcakton në detaje metodologjinë për hartimin e PZHK-ve në Kosovë, dhe ofron disa rekomandime dhe ide se si PZHK-të duhet të reflektojnë në të gjithë sektorët dhe çështjet e ndërlidhura. PZHK-të janë thelbësore për formësimin e dokumenteve për zhvillimin dhe menaxhimin e ardhshëm të territoreve të Kosovës. Si i tillë, udhëzuesi do të ofrojë edhe drejtimet shumë të nevojshme për hartimin e të gjitha fazave të PZHK-së, përfshirë zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin.

## Udhëzuesi për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Kz udhëzues është rezultat i përvojës së MuSPP-it në Kosovë, në mbështetjen e proceseve të planifikimit hapësinor dhe mjedisor. Ai kanë për qëllim të ndihmojnë qeveritë qendrore dhe lokale duke ofruar rekomandime për zbatimin e Vlerësimit Mjedisor Strategjik (SEA) në Kosovë, pas harmonizimit të legjisllacionit të Kosovës me Direktivën e Bashkimit Evropian për VSM-në, të vitit 2001, në veçanti në lidhje me proceset e planifikimit hapësinor.

Ky udhëzues është organizuar në atë mënyrë që të inkurajojë përdoruesit të marrin në konsideratë ndikimet mjedisore të planeve dhe programeve në kontekste të veçanta të planifikimit hapësinor. Gjetjet nga proceset e para të VSM-ve në Kosovë kanë vendosur bazën për udhëzues dhe duhet të ofrojnë mësim të rëndësishme për komunitetet e tjera, si në Kosovë ashtu edhe në rajonin e Ballkanit, pasi që ai merr në konsideratë opsione të ndryshme për planifikimin mjedisor dhe planifikimin e integruar zhvillimor. Përveç vlerësimit të planit, vlerësimi mjedisor në kontekstin e Kosovës duhet të ofrojë mundësi për të rritur ndërgjegjësimin ndaj konsideratave mjedisore gjatë planifikimit. Ajo gjithashtu duhet të përfshijë një sërë masash zbutëse të monitorimit që do të zhvillohen më tutje nga ana e komunave gjatë zbatimit të planeve të tyre zhvillimore, si pjesë e një qasjeje të integruar për planifikimin efektiv të zhvillimit të qëndrueshëm.

## Udhëzuesi për menaxhimin e Projekteve të Investimeve kapitale: 'Mësimet e nxjerra nga MuSPP-i'

PIK-ët janë një fushë e rëndësishme e mbështetjes nga MuSPP-i, të cilat janë asete të ndjeshme që rezultojnë nga proceset e planifikimit hapësinor. Veçanërisht, është bërë shumë në drejtim të krijimit të hapësirave. Ky udhëzues, është i bazuar në mësimet e nxjerra nga MuSPP-i dhe synon ofrimin e disa këshillave praktike për ciklin e PIK-ve. Identifikimi i PIK-ve, projektimi, zbatimi dhe mirëmbajtja është një proces kompleks që përfshin jo vetëm stafin e komunës, por gjithashtu edhe komunitetin e bizneseve, organizatave të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare si dhe shoqërinë civile. Ky udhëzues 'hap-pas-hapi' përmban informacione të dobishme dhe praktike mbi rolet dhe përgjegjësit e të gjitha palëve të interesuara gjatë procesit, mbi teknikat metodologjike dhe detyrat kronologjike, si dhe listën kontrolluese që ndërlidhet me to, për të realizuar një PIK nga fillimi deri në fund. Disa raste studimore në komunitetet partnere të MuSPP-it sjellin një perspektivë shtesë në demonstrimin e suksesit të këtij procesi.

## Shndërrimi i Hapësirave në Vende - Doracak

Si plotësues i 'Udhëzuesit për menaxhimin e Projekteve të Investimeve Kapitale', ky doracak përshkruan karakteristikat kryesore të projektimit themelor të "vendeve të mira publike", duke prezantuar disa koncepte globale dhe shembuj lokal. Ai gjithashtu ka për qëllim të stimulojë diskutime, ide, të menduar në mënyrë kolektive dhe rritje të ndërgjegjësimit tek vendimmarrësit rreth 'vend-bërjes' kundrejt 'mirëmbajtjes së hapësirës'. Doracaku shpjegon qartë se çfarë është 'vend-bërja', dhe mbi të gjitha se si vend-bërja ndikon në jetët e njerëzve dhe se si mund të arrihet ajo. Doracaku zhvillon disa parime dhe teknika të projektimit dhe përmban shembuj të vërtetë dhe frymëzues të nxitur nga PIK-ët e realizuar nga MuSPP-i në komunitetet partnere.



## MuSPP-i - Puna me partnerët

MuSPP-i ka punuar me shumë partnerë, gjatë koordinimit të projekteve dhe gjatë këshilimit në hartimin dhe zbatimin e ligjeve.

### Friedrich Ebert Stiftung (FES-i)

Friedrich Ebert Stiftung (FES-i) është një OJQ e pavarur e cila promovon demokracinë sociale. OJQ-ja e cila vepron në nëntëdhjetë vende ka zyrën e saj edhe në Kosovë.



**Besa Luzha** është Koordinatore e Programit të FES-it në Kosovë dhe ajo shpjegon përvojat e saj gjatë punës me MuSPP-in. Në fillim ajo ishte skeptike nëse planerët do të praninin mënyrat e reja të punës dhe nëse do të mund të përfshihej komuniteti. Element kyç në planifikimin me pjesëmarrje është pjesëmarrja e njerëzve nga të gjitha pjesët e komunitetit. Besa mori pjesë në punëtorinë e parë të Vizionimit në Shkup më 2007 dhe FES-i ka mbështetur përpjekjet e MuSPP-it që atëherë, nganjëherë financiarisht, dhe shpesh herë duke i inkurajuar njerëzit nga shoqëria civile që të marrin pjesë në ngjarjet e planifikimit, si në punëtoritë ashtu edhe në tryezat e rrumbullakëta përcjellëse, si dhe ngjarjet për kryetarë të komunave dhe stafin e ministrisë. FES-i ka mbështetur punëtorinë e Trajnimit Gjinnor e cila synonte

formulimin e udhëzuesit gjinnor, që u mbajt në Durrës, Shqipëri, si dhe tryezave të rrumbullakëta gjinore në të cilin ishin të ftuara të gjitha komunat e Kosovës.

E pyetur për ndikimin që MuSPP-i ka bërë deri më sot, ajo u përgjigj:

*"Të shihje njerëzit që punojnë me aq entuziazëm gjatë pesë ditëve në një punëtori të Vizionimit, duke i treguar nevojat e tyre dhe duke bërë sugjerime konkrete, nganjëherë duke diskutuar për dy orë për një rrugë ose një shkollë, në mënyrë që të bëjnë listën e tyre të dëshirave të asaj se çka duhet vendoset në hapësirë, ishte mbresëlënëse.*

*Në Mitrovicën e ndjeshme politikisht, MuSPP-i solli Veriun dhe Jugun së bashku, dhe ata harruan dallimet e tyre dhe me entuziazëm bënë një plan.*

*Pjesëmarrja në punëtoritë gjinore ndikoi në përfshirjen e grave ku zëri i tyre u dëgjua dhe ato ndikuan në procesin e planifikimit. Kjo ndodhi vetëm për shkak të qasjes së MuSPP-it me pjesëmarrje - demokracia në qeverisjen lokale - është e rëndësishme. **Kështu funksionon demokracia në qeverisjen lokale!"***

### Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB-ja)

Së bashku me CHwB-në, MuSPP-i ka mbështetur ngjarjen vjetore Tour de Culture, e cila ka mobilizuar mijëra njerëz për të shkuar në vendet kulturore në të gjithë Kosovën (Shih Tour de Culture). CHwB-ja ishte gjithashtu një nga partnerët të cilët kanë punuar në PZHK-në e parë të hartuar me kapacitete vetanake në komunë, për komunën e Junikut.

Sali Shoshi, Udhëeqës i Misionit të CHwB-së në Kosovë ishte i impresionuar se si udhëzuesit dhe trajnimet e MuSPP-it ia mundësuan Ferdane Tofajt, e cili mori pjesë në punëtorinë e vizionimit të Junikut, të ketë vetëbesim të prezantoj PZHK-në e Junikut në Konferencën e Vjenës. Ai shpjegoi, "Ajo ka mësuar se sa i rëndësishëm është restaurimi i vazhdueshëm i trashëgimisë kulturore".

CHwB-ja ka punuar me FES-in në Konferencën e Vizionimit dhe kanë bërë qasjen e MuSPP-it me pjesëmarrje, pjesë përbërëse në shtatë komuna në të cilat ata janë duke punuar tani. Të gjitha komunat kanë Forume Lokale të Trashëgimisë të organizuara me një qasje me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe konsultime publike, që u dhan të gjithë palëve të interesit 30 ditë në dispozicion për të bërë komente.

Z. Shoshi beson se punëtoritë e vizionimit kanë bërë një ndikim të rëndësishëm dhe që MuSPP-i nuk ka sjellë vetëm komunitetin por edhe partnerët së bashku, duke krijuar një sinergji të sigurtë. "Planerët kanë mësuar si të vizatojnë, MuSPP-i u ka mësuar atyre se si të planifikojnë," tha ai.

### Partnerët tjerë Kryesor të UN-Habitat-it

Partnerët tjerë kryesorë të cilët kanë punuar në shumë projekte me MuSPP-in janë **Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK-ja)**, **Bashkimi Evropian**, **USAID-i**, veçanërisht në hartimin dhe komentimin e ligjeve. Janë organizuar disa ngjarje të përbashkëta me **OSBE-në (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë)** veçanërisht për vendbanime joformale, **Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC)**, dhe **Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-Lindore (NALAS)**.

# Aktivitetet e MuSPP-it për Arritje deri te Komuniteti

## Tour de Culture



Tour de Culture  
Fotografi © Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB)

Nga viti 2008 deri në vitin 2013, Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB-ja) dhe MuSPP-i kanë organizuar Tour de Culture. Qindra vetë morën pjesë në këtë ngjarje dhe shumë më tepër e kanë përcjellur atë . Tour de Culture është aktiviteti i vetëm i çiklizmit jo-konkurrues dhe rekreativ në Kosovë i hapur për të gjithë, për profesionistë dhe amatorë, për të rinj dhe të moshuar, për burra dhe gra. Kjo ngjarje vjetore është bërë një aktivitet tradicional në Kosovë duke zbuluar çdo skaj të Kosovës. Kjo është arritur me anë të rritjes çdo vit të numrit të pjesëmarrësve entuziastë dhe mbështetjes së madhe nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe bizneseve lokale dhe mediave.

2009



2010



2011



2012



Ky aktivitet unik në Kosovë përbëhet nga sinergjitë që dalin nga parimet e Ditëve e Trashëgimisë Evropiane dhe Javës së Mobilitetit Evropian, e cila festohet në të gjithë Evropën gjatë muajit shtator.


### ***“NE NGASIM BIÇIKLETËN PËR...***

***Promovimin e trashëgimisë sonë të përbashkët natyrore dhe kulturore***

***Promovimin e transportit jo-motorik për lëvizshmëri më efikase për të gjithë***

***Promovimin e mbrojtjes së mjedisit“***

Tour de Culture  
Fotografi © Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB)



## Festimi i Ditës Botërore të Habitatit

Kombet e Bashkuara kanë caktuar të hënën e parë të muajit tetor si Ditën Botërore të Habitatit (DBH). Qëllimi i Ditës Botërore të Habitatit është të reflektojë mbi gjendjen e qytezave dhe qyteteve. Çdo vit, Dita Botërore e Habitatit zgjedh një temë të re në bazë të çështjeve aktuale dhe trendeve të reja relevante për Agjendën e Habitatit.

Në këtë frymë, MuSPP-i organizoi ngjarje të veçanta në terren. Më poshtë janë disa shembuj të ngjarjeve të DBH të mbajtura në Kosovë të cilat përfshinë të gjithë, liderët dhe qytetarët, për të formësuar të ardhmen e qyteteve dhe fshatrave të tyre.

### Dita Botërore e Habitatit 2006

Në tetor të vitit 2006 ngjarjet kryesore ishin garat në vizatim:

Më Pejë, nxënësit e shkollave fillore morën pjesë në **punëtorinë praktike** për mjedisin.



Dita Botërore e Habitatit në Gjilan u festua me **garë vizatimi për nxënësit e shkollës fillore rreth temës së Ditës Botërore të Habitatit: "Qytetet-magnete të shpresës"**

### Dita Botërore e Habitatit 2007

Tema e këtij viti ishte **"Qyteti i sigurt është një qytet i vetëm"**.

Në **Gjilan** u mbajt një debat publik për rëndësinë e sigurisë në qytet. Në **Prizren** ngjarja i dha rast qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe nxënësve, të shprehin idetë e tyre mbi sfidat aktuale dhe të ardhshme mbi mjedisin jetësor dhe se si ata i shohin çështjet e sigurisë në qytetin e tyre. Në **Gjakovë** u mbajt një diskutim rreth rezultateve të një sondazhi të mendimit mbi sigurinë e vendeve publike dhe në **Pejë** u mbajt një takim konsultativ i Grupit të Palëve të interesit të mobilitetit.



Dita Botërore e Habitatit, në Gjakovë dhe Prizren.



### Dita Botërore e Habitatit 2011

Dita u shënua me një tryezë të rumbullakët për qeverisjen qendrore dhe lokale në Kosovë, për të diskutuar çështjen "Qytetet dhe ndryshimet klimatike" me ekspertë, udhëheqës dhe profesionistë relevantë.

### Dita Botërore e Habitatit 2013


Me këtë rast, MuSPP-i së bashku me MMPH-në, bashkuan forcat për të festuar Ditën Botërore të Habitatit dhe organizuan një seminar me temën **"Qytetet e Kosovës në tranzicion: drejt brezit të dytë të planeve komunale"**. Seminari kishte për qëllim diskutimin e implementimit, monitorimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të të arriturave në procesin planifikues komunal në Kosovë nga perspektiva e zbatimit të Ligjit të ri për Planifikimin Hapësinor, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013. Seminari dhe debati mbi fazën pas PZHK-ve dhe brezin e ri të planeve hapësinore për komunat e Kosovës gjithashtu përfshiu përvojat nga rajoni.



## Forumi Urban Botëror

Në mënyrë që të arrihet publiku mbarë botëror, MuSPP-i dhe MMPH-ja kanë prezantuar aktivitetet e Planifikimit Hapësinor në Kosovë në Forumin Urban Botëror (FUB). Forumi, i mbajtur çdo dy vjet, shqyrton urbanizimin e shpejtë dhe ndikimet e tij mbi komunitete, qytete, ekonomi dhe politika.

MuSPP-i në FUB 2006, në Vankuver, Kanada



Zyrtari i MuSPP-it ia prezantoi pjesëmarrësve të FUB **zhvillimin urban dhe mjedisor të Kosovës**. Është konkluduar se të gjithë akterët urban duhet të punojnë më shumë për të zgjidhur problemet dhe sfidat urbane, dhe se ndërmarrja e rrezikut dhe inovacionet duhet të karakterizojnë qeverisjen lokale. Gjithashtu u theksua rëndësia e transparencës dhe llogaridhënies. Më e rëndësishmja që u vu në pah ishte nevoja për ndërtim të partneritetit dhe marrëdhënia me komunitetin, në mënyrë që problemet të zgjidhen bashkërisht.

MuSPP-i në FUB 2012, në Napoli, Itali



Forumu u përqendrua në çështje të ndryshme të ndërlidhura me temën qendrore të konferencës, "E Ardhmja Urbane" dhe u konceptua si platformë ku segmente të ndryshme të shoqërisë mund të diskutojnë, mësojnë, praktikojnë, të pajtohen, dhe të mos pajtohen në mënyra të ndryshme për të ndërtuar një të ardhme më të suksesëshme urbane për qytetet e tyre.

Përfaqësuesit e **CHWB-së dhe MuSPP-it paraqitën përvojat e Kosovës** se si shoqëria e saj e pasluftës po merret me planifikimin dhe trashëgiminë kulturore, në të cilën morën pjesë anëtarët e FUB-it nga e gjithë bota. Pothuajse 8.000 njerëz morën pjesë në Forumin e këtij viti.

# Hapat e Ardhshëm

## Për të siguruar qëndrueshmërinë e arritjeve të MuSPP-it...

- Prezantimi i **Planifikimit Hapësinor me Pjesëmarrje për të gjitha Komunitet Partnerë të MuSPP-it, veçanërisht përdorimi i mjeteve të Vizionimit** për t'i ndihmuar planerët të përfshijnë të gjithë sektorët e shoqërisë në procesin e planifikimit, e veçanërisht **gratë, nëpërmjet integritimit gjinor, minoriteteve, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.**
- Futja e praktikës së **ndihmës në baza ditore në vend të punës** për t'i ndihmuar planerët komunal që të hartojnë PZHK-të me kapacitete vetanake në komunë, e cila ka rezultuar në ngritjen e kapaciteteve të planifikimit hapësinor.
- Hartimi i **PZHK-ve dhe VSM-ve në Komunitet e MuSPP-it**, ofrimi i **trajnimeve për GIS-in dhe testimi i praktikave** të Udhëzimit Administrativ për PZHK-në, të dalë nga Ligji për Planifikimin Hapësinor të vitit 2013.
- Zbatimi i projekteve praktike **gjithëpërfshirëse të investimeve kapitale, duke përdorur idetë e njerëzve vendorë për të jetësuar prioritetet strategjike të PZHK-së.**
- Krijimi i **një mjedisi të përgjegjshëm të punës** të ndërtuar mbi **lidhjen dy-kahore të komunikimit ndërmjet ministrive dhe komunave**, duke krijuar kështu mundësi për institucionet qendrore që të kenë kapacitete të zgjeruara për t'i mbështetur komunitet.
- Hartimi i **udhëzuesve dhe publikimeve relevante** që shërbejnë si bazë për mjetet e punës së MuSPP-it të cilat do të jetë një **trashëgimi e përhershme e MuSPP-it.**

...Dhe për të siguruar udhëzime **të qasshme për të gjitha komunitet e Kosovës**, MuSPP-i ka zhvilluar një përmbledhje udhëzuesish të bazuar në metodologjitë dhe sukseset e programit: **'Përmbledhje udhëzuesish praktik nga MuSPP-i: Udhërrëfytyesi ynë drejt vetëqëndrueshmërisë'**

## Çfarë është Përmbledhja e Udhëzuesve të MuSPP-it?

**Përmbledhja e udhëzuesve praktik të MuSPP-it** është një koleksion i instrumenteve, të hartuar në bazë të përvojës së krijuar të programit gjatë viteve të funksionimit në kontekstin kosovar, që përmban doracakë, udhëzues të plotësuar me praktikën më të mira dhe raste studimore, teknika për menaxhim të projekteve si dhe përshkrimeve dhe detyrave dhe përgjegjësi për angazhim të mbështetjes. Ky është një resurs për institucionet që ndërmarrin procese të planifikimit dhe menaxhimit hapësinor dhe mjedisor.

## Cili është qëllimi i Përmbledhjes së udhëzuesve të MuSPP-it?

Qëllimi i përmbledhjes së udhëzuesve të MuSPP-it është që t'ju mundësojë planerëve komunal që të ndërmarrin aktivitete të planifikimit hapësinor përmes proceseve të planifikimit me pjesëmarrje si dhe aplikimit të teknikave inovative të planifikimit hapësinor. Kjo i'u ofron grupeve të komunitetit dhe palëve të interesit të kuptojnë më mirë rolin dhe nivelin e kontributit të tyre të pritur gjatë procesit të planifikimit. Përmbledhja shërben si mënyrë për transferimin e njohurive të MuSPP-it, duke rezultuar në gamë të gjerë të njohurive të palëve të interesit lidhur me çështjet e planifikimit hapësinor.

## Kujt i shërben përmbledhja e udhëzuesve?

Përmbledhja e udhëzuesve do të jetë në shërbim të të gjitha palëve të përfshira në procesin e planifikimit hapësinor, duke përfshirë institucionet qeveritare në nivel qendror dhe lokal, si udhëheqjen politike dhe stafin teknik, organizatat jo-qeveritare, universitetet, sektorin privat (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), shoqatat profesionale, shoqërinë civile, personat me nevoja të veçanta, grupet e pakicave, dhe të rinjtë.

## Çfarë përmbanë përmbledhja e udhëzuesve?

Përmbledhja përqendrohet në pesë fusha, secila me përmbajtje të udhëzuesve mbi aspekte specifike të planifikimit hapësinor.

- **Qasja me Pjesëmarrje dhe Gjithëpërfshirje në Planifikimin Hapësinor**, e cila përqendrohet në Vizionim, Integrim Gjikor dhe Pjesëmarrjen Publike.
- **Planifikimi dhe Menaxhimi Hapësinor**, që mbulon hartimin, zhvillimin dhe implementimin e Planeve Zhvillimore Komunale.
- **Planifikimi Sektorial- Banimi**, që ofron hollësi për rastin specifik të Profilit të Banimit në Komunën e Gjilanit, si dhe një shënim udhëzues për hartimin e një 'Profilit Komunal të Banimit'.
- **Planifikimi dhe Menaxhimi Mjedisor**, i cili ofron një spektër të gjerë të informatave mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Menaxhimin Lokal të Mbeturave të Ngurta.
- **Projektet e Investimeve Kapitale**, që ofron udhëzime për menaxhimin dhe implementimin e PIK-ëve për të siguruar 'vend-bërje' adekuate publike.

Ekipi i MuSPP-it ka hartuar '**Përmbledhjen e udhëzuesve praktik të 'MuSPP-it: Udhërrëfytyesi ynë për vetëqëndrueshmeri'** për të ndihmuar në implementimin e proceseve të reja të planifikimit normalisht. Ajo është menduar të jetë në përdorim të të gjitha 38 komunave të Kosovës, në mënyrë që të gjitha komunat të jenë 'gatëshme për pjesën tjetër të udhëtimit'.

*Kënaquni në udhëtim...Për një të Ardhme më të Mirë Urbane!*



## UN HABITAT

UNITED NATIONS HUMAN SETTLEMENTS PROGRAMME

Objekti i Ministrive "Rilindja", kati i 10-të, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 200 32611; Fax: +381 38 224 122

[office@unhabitat-kosovo.org](mailto:office@unhabitat-kosovo.org); [www.unhabitat-kosovo.org](http://www.unhabitat-kosovo.org); [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org)

